ISSN 1857-6443

Hulumtim

Gjykatësit i njohin kolegët e korruptuar

Fq.5

POLITIKAT ARSIMORE

Mungesa e mjeshtërve, problem shoqëror

Fq.4

Shehidët e ditëve tona

Forum

Fq.10

www.koha.mk

Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3385 · E shtunë/e diel, 9-10 qershor 2018 · 17°C | 27°C · 15 DEN



KOHA për enigmë

Fq.12-15

FORUM

Shëndetësia shëndetligë!

Nuk është faji i tij që nuk është i aftë në këtë punë, është faji i atyre që, edhe pse po shohin rënien e menjëhershme të nivelit të shëndetësisë, vazhdojnë dhe e mbajnë ministër. Përsëris që është një mjek brilant i dënuar të vuajë dështimin si ministër! Kjo Qeveri ka falimentuar në një sektor që e kam shumë për zemër, e për më shumë që është jetike për vendin...

Fq.11

KULTURË

Matevski, akademiku me njohje erudite

Fq.18

GLOBI

Trump i mërzitur, nuk i lejohet të shikojë porno në Shtëpinë e Bardhë

Fq.17

SHQIPTARËT JASHTË VENDIT

DIASPORËS I DUHET ME SHUMË SE NJË AGJENCI

Sipas të dhënave zyrtare, numri i shqiptarëve të emigruar nga Maqedonia është mbi 500 mijë, shifër kjo që supozohet të jetë dyfish më e madhe. Por shanset për të forcuar lidhjet me vendlindjen që ofrohen nga institucionet shtetërore janë të vogla, si për të ruajtur traditat dhe kulturën, gjuhën amtare, por edhe për të krijuar kushte të favorshme për investime në vendlindje

Fq.3

Për gjashtë vite, 4000 maturantë më pak!

Shkup, 9 qershor - Arsimi i mesëm i obligueshëm nga viti 2007, siç edhe pritej, rriti në mënyrë permanente numrin e nxënësve në këtë nivel shkollimi. Por kjo ndodhi vetëm për pak vite, deri në vitin shkollor 2010/2011, pra deri kur në këtë nivel shkollimi u përfshinë 100 për qind e popullatës nga 15 deri në 19 vjet. Menjëherë pas kësaj filloi rënia, pasi numri i nxënësve që ndjekin shkollimin e mesëm në Maqedoni iu dorëzua dukurisë së rënies së përgjithshme të numrit të popullsisë së kësaj moshe e që është rezultat i faktorëve social e demografik, sikurse janë shkalla e natalitetit apo edhe migrimet e shumta. Rënia e viteve të fundit, padyshim se është reflektuar edhe në numrin e nxënësve që kryejnë arsimin e mesëm dhe që ka tregues përkatës numrin e atyre që paraqesin provimet e Maturës Shtetërore...

Fq.7

EDITORIAL

TIGRAT DHE ZVARRANIKËT

Emin AZEMI

Deri më tani nuk ka kurrfarë ndryshimi apo paralajmërimi për riemërime të komandantëve dhe zëvendëskomandantëve të rinj në njësinë special "Tigrat". Kështu kanë thënë burime të MPB për shtypin maqedonas, pas njoftimeve se një shqiptar etnik do të përfshihet në këtë njësit. Bëhej fjalë për Llokman Selimin, i cili është paralajmëruar se mund të jetë zv.komanadant i njësitit special "Tigrat", një pozicion ky i paarritshëm deri më tani për kuadro shqiptarë. Selimi është një efektiv i forcave speciale të policisë me origjinë nga Haraçina e Shkupit. Ai edhe mund të jetë një nga udhëheqësit e "Tigrave", ndonëse për këtë nuk ka njoftim zyrtar, por mënyra se si ky informacion u plasua në mediat maqedonase ishte gati si një dridhje që shkakton rënia e ndonjë asteroidi gjigant në tokë. Gazetaria "hulumtuese" maqedonase mendon se ardhja e një kuadri shqiptar në këtë njësi të specializuar, paraqet lajm madhor. Dhe furia e këtij lajmi ka për qëllim të mbështjell publikun me efektin spektakular të një ngjarjeje, e cila nuk do të duhej të ndodhte. Pra, kësaj gazetarie nuk i bën përshtypje fakti se kjo njësi është e pastër etnikisht me maqedonas dhe e specializuar për të ndërhy në lagjet dhe shtëpitë e shqiptarëve, ku dorën në zemër mund të ketë edhe ndonjë keqbërës, por i bën përshtypje që këto aksione do të mund t'i udhëheq edhe ndonjë kuadër shqiptarë.

Një shtet demokratik nuk mund të ndërtohet duke na e shitur "pastërtinë etnike" si garancë e funksionimit të disa segmenteve të sigurisë. Se çfarë "garance" mund të japin këto segmente, dëshmuan ngjarjet e dhunshme të 27 prillit të vitit të kaluar, kur të ashtuquajturit efektivë special lëshuan pantallonat para turmave huligane të rrugës që ia mësyen Parlamentit. Askush nuk do ta besonte se në ato ngjarje të përgjakshme do të dilte një kuadër shqiptar që do të shprehte gatishmërinë e rrezikimit të jetës së tij për të mbrojtur jetën e deputetëve dhe integritetin e institucionit shtetëror. Është po ai kuadër që tani propozohet të jetë zv.komanadant i "Tigrave", për të cilin gazetaria maqedonase ende nuk ka dhënë "vizë".

Shqiptarët ende nuk kanë qasje në njësitet speciale të policisë e ushtrisë. Janë edhe disa institucione ku "pastërtia etnike" konsiderohet si etiketë e shenjtë që e bën maqedonizmin më superior. Në fakt , ky realitet jep të kuptosh se mendësia nuk ndryshon shpejt, sidomos kur duhet të pranohen shqiptarët si vlera të një shoqërie që proklamohet e barabartë për të gjithë. Ajo çka e bënë këtë mendësi edhe më vajtuese është bindja e formuar në kokat e disa intelektualëve e gazetarëve maqedonas, të cilët habiten me realitetin që duhet të përfshijë një diversitet gjuhësh e kulturash. Ata ende mund të kenë ndonjë nostalgji për Beogradin e Esad Mekulit që ishte zemërgjerë me shqiptarët sharraxhinjë. "Dru me pre", ishte refreni i një apoteoze të dhimbshme jo vetëm sociale, por edhe i një realiteti që krijonte hierarkinë e qytetarëve superior dhe katundarëve inferior. Këta të fundit ishin të parapaguar të jenë shqiptarë dhe atyre nuk iu lejohej kurrfarë fisnikërie dhe qytetarie në sjelljet e tyre.

Tani kur një shqiptar(vetëm një, jo më shumë) propozohet të jetë në komandën e njësitit special "Tigrat", askush prej mediave maqedonase nuk e ka marrë mundin të sheh biografinë e këtij djaloshi. Të shohin se ai është një kuadër që i del zot punës së tij, se ai rrjedhe prej një familje fisnike dhe se të qenit me uniformë zyrtare nuk paraqet kurrfarë kërcënimi për shtetin që ende nuk e gjeti një emër që do të kënaqte të gjitha palët. Janë po të njëjtat media që transmetojnë top listat britanike të këngëve hit që emetohen brenda javës, e ku Dua Lipa si zakonisht është në krye të këtyre listave. Por asnjë gazetari në Londër nuk i ka rrjedhë mendja të vë në dyshime cilësinë e vokalit të kësaj këngëtareje, e cila nuk e ka fshehur se është me origjinë shqiptare. Ngjashëm është edhe me Rita Orën, Bebe Rexhën, Gjerdan Shaqirin, të cilët u bënë të famshëm jo pse janë shqiptarë, por pse shqiptarësinë e tyre askush nuk e mori si alibi për të mohuar vlerat që kanë. Përkundrazi, në një botë të lirë, ku njeriu vlen më tepër se kurthet e përkatësive e identiteteve, mund të jenë të suksesshëm edhe ata që jo domosdoshmërisht duhet të jenë etnikisht britanikë, zviceranë, amerikanë etj.

Në Maqedoni është pak më ndryshe. Këtu ende besueshmëria matet ose në bazë të një lojaliteti të skajshëm që mund të përkthehet edhe si zvarritje për një kothere bukë pushteti, ose në bazë të një kosmoplitizmi që si kush ka heqjen dorë nga përkatësia etnike. Në njësitet speciale të policisë dhe ushtrisë në Maqedoni, shqiptarët ende nuk kanë qasje dhe përderisa është kështu edhe rrëfimet për lojalitetin bëhen gjithnjë e më të bajatshme.

Llokman Selimi nuk ka nevojë të luajë trika zvarranikësh për t'u bërë "tigër". 27 prilli i vitit të kaluar tregoi se kush është tigër i vërtetë e kush zvarranik që shkelet nga çizmet e huliganëve.

NËSE NUK E KENI DITUR...

EDHE BULLGARËT UA FUTËN

"Si ua futën këtyre sundimtarëve tanë edhe bullgarët? Po ja, në fillim edhe duke e ditur se nuk kishte shans për hapje bisedimesh, u premtuan se do të bënin çmosin për të hapur bisedimet. Por kishin kushte të vogla si te shpallet një minoritet bullgar në shtetin shqiptar dhe ca koncesione të tjera. Bullgarët duan edhe Maedoninë, siç është dhe siç e patën gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe kjo do të thotë se nuk ka zgjidhje të problemit etnik shqiptar. Këta e pranuan dhe i bënë të gjitha... Tani bullgarët thonë se janë nja tre shtete që nuk duan të hapen bisedimet në asnjë mënyrë sepse me demek ata kanë bërë çdo gjë që kanë mundur, edhe me shume!!! Shkurt, përfunduan si ajo që donte burrë dhe kaloi në duart e gjithë lagjes... Dobiçi që u ngeli në derë shqiptareve janë 100000 vetët e minoritetit bullgar nga Hasi e deri ne Pogradec, dhe në Tiranë. A ka farë më të keqe? Edhe bullgarët ua futën....", shkruan në profilin e tij në Facebook, prof. Shenasi Rama.

RUGOVA, SI TRASHËGIMI BIOLOGJIKE,POR JO EDHE POLITIKE

"Ata që nuk besojnë në idenë e lobimit, janë të verbër politikisht. Lobimi nuk është zëvendësim i detyrave të shtëpisë për të ndodhur liberalizimi, por është një aktivitet suplementar gjithsesi i dobishëm dhe funksional. Prania e vajzës së Ibrahim Rugovës në delegacionin parlamentar që po viziton Evropën, i rikthen asaj kujtesën për Kosovën proevropiane të Rugovës. Ne kemi nevojë për t'i kujtuar Evropës se kush ishim, ndërkohë që më nuk jemi! Këtë pra e bëjmë duke prezantuar trashëgiminë biologjike të Ibrahim Rugovës, përderisa tradhëgimia e tij politike nuk ekziston. Prania e Teuta Rugovës në Evropë zgjon më shumë venendje sesa vetë Isa Mustafa, apo më shumë se e tërë udhëheqja kolektive e LDK-së. Teuta Rugova, pa asnjë fjalë, por vetëm me buzëqeshjen e saj të trashëguar nga i ati", është shprehur në një postim të tij në Facebook, Liri Loshi.

MEDIACitate

UNIVERSITETI ETH I CYRIHUT, I SHTATI NË BOTË, I PARI NË EVROPËN KONTINENTALE

Vendin e parë në mesin e të gjithë universiteteve të botës sipas QS e ka merituar sërish universiteti Massachussetts Institute of Technology (MIT). Universiteti Teknik i Cyrihut, ETH, prej kohësh rangohet në mesin e universiteteve më të avancuara në botë, shpeshherë si më i vlerësuari në kontinentin evropian, shkruan albinfo.ch.

Në ranglistën më të re të universiteteve, të realizuar nga organizata këshillimore e shkollave të larta, QS, universiteti ETH ka zënë vendin e shtatë në botë.

Në këtë shkallë ETH ka përforcuar edhe një herë pozitën e universitetit numër një në Evropën kontinentale (ku përjashtohet Britania e Madhe) dhe është ngjitur për tre vende më lart se sa ishte në vlerësimin e vitit të kaluar. Ndërsa vendin e parë në mesin e të gjithë universiteteve të botës sipas QS e ka merituar sërsih universiteti Massachussetts Institute of Technology (MIT), transmeton albinfo.ch. Edhe tre universitetet tjerë në krye të listës janë universitete amerikane, gjegjësisht Stanford, Harvard dhe Caltrech, që ndajnë vendet 2 deri 4, pa pësuar asnjë ndryshim në krahasim me një vit më parë. Ndërkaq universiteti më i vlerësuar jashtë SHBA-së është ai i Oksfordit, i cili zë vendin e pestë në botë. Ai kësaj here ka këmbyer pozitën me rivalin e tij tradicional, Universitetin e Kembrixhit, i cili ka mbetur në vendin e gjashtë.

Nga universitetet zvicerane, një pozitë të lartë e ka zënë EPLF i Lozanës, ndonëse ka pësuar një rënie të theksuar në krahasim me vitin e kaluar: nga vendi 12 në atë 22.

(Albinfo.ch, 8 qershor)

ÇFARË DIHET PËR HISTORINË E VOSKOPOJËS?

Voskopoja dëshmohet si fshat i vjetër që në shek.XIV.

Në shek.XVII-XVIII u bë një qytet i madh i begatshëm me rreth 20.000 banorë, një nga qendrat kryesore ekonomike e kulturore të vendit me artizanat të zhvilluar.

Kishte marrëdhënie tregtare me shumë vende të huaja (Venedikun, Vjenën, Lajpcigun etj.). Këtu lulëzoi një veprimtari e gjerë arsimore e kulturore, që gjeti shprehje në themelimin e Akademisë së re dhe të një shtypshkronje më 1720.

Të kësaj periudhe janë një varg monumentesh kulture, si manastiri i Shën Prodhromit dhe një varg bazilikash. Rënia e Voskopojës filloi pas djegies së parë të saj më 1769, që u pasua nga dy djegie të tjera.

SHQIPTARËT JASHTË VENDIT

DIASPORËS I DUHET MË SHUMË SE NJË AGJENCI

Sipas të dhënave zyrtare, numri i shqiptarëve të emigruar nga Maqedonia është mbi 500 mijë, shifër kjo që supozohet të jetë dyfish më e madhe. Por shanset për të forcuar lidhjet me vendlindjen që ofrohen nga institucionet shtetërore janë të vogla, si për të ruajtur traditat dhe kulturën, gjuhën amtare, por edhe për të krijuar kushte të favorshme për investime në vendlindje

Koha — Evis HALILI

Shkup, 8 qershor - Furnizimi me tekste shkollore në gjuhën amtare është një prej kërkesave kryesorë që diaspora ia adreson Agjencisë së Emigracionit, institucionit që funksionon për të emigruarit jashtë Maqedonisë që të mos humbin lidhjet me vendlindjen. Nga agjencia bëjnë me dije se një prej projekteve që është në përgatitje e sipër ka të bëjë me hartimin e disa teksteve shkollore adekuate në maqedonisht dhe shqip për të përmbushur nevojat e arsimimit të fëmijëve. Barrierat ligjore për porositjen e këtyre teksteve nga shërbimi pedagogjik i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës janë tejkaluar dhe nga fillimi i vitit të ri shkollor, shkollat në diasporë do të kenë mundësi të furnizohen me libra që janë pjesë e sistemit arsimor.

Sipas të dhënave zyrtare, numri i shqiptarëve të emigruar nga Maqedonia është mbi 500 mijë, shifër kjo që supozohet të jetë dyfish më e madhe. Por shanset për të forcuar lidhjet me vendlindjen që ofrohen nga institucionet shtetërore janë të vogla, si për të ruajtur traditat dhe kulturës, gjuhën amtare, por edhe për të krijuar kushte të favorshme për investimin në vendlindje.

Pavarësisht ekzistimit prej shumë vitesh të Agjencisë së Emigracionit, e çeljes së ministreve të diasporës, si në Maqedoni, por edhe në Kosovë e Shqipëri, ende mungojnë politika e projekte të përbashkëta që do të afronin shqiptarët me vendet nga ato vijnë. Zëvendësdrejtori i kësaj Agjencie, Osman Shukriu, thotë se nevojat e diasporës pjesërisht mbulohen, me përjashtim vendet e Evropës, ndërsa në kontinentet e tjera asistenca është më e vogël. buxheti me të cilin disponon agjencia është i vogël, dhe sipas Shukriut, më shumë sesa me institucionet vendase kujdesi për diasporën shqiptare orientohet tek bashkëpunimi me dy ministritë e diasporës, të hapura në Kosovë dhe Shqipëri.

"Kam kërkuar që të paktën ne si shtet të mundësojmë mikpritjen e duhur në pikat e kalimit kufitar dhe të kenë trajtimin e duhur nga autoritet doganore. Po ashtu edhe me komunat duhet që të punohet për të ngritur zyra për diasporën, në mënyrë që gjatë periudhës së shkurtër të qëndrimit të kenë lehtësira në procedurat e ndryshme për dokumentacione. Ndërsa në kontaktet që kam pasur me ministritë e diasporës në Kosovë dhe Shqipëri, mundohemi të bashkëpunojmë për të koordinuar aktivitetet, sidomos furnizimin me tekste për nxënësit në shkollat plotësuese në gjuhën shqipe", thotë Shukriu. Përfaqësues të diapsorës dhe aktivistë të çështjes shqiptare jashtë vendit pohojnë se falë politikave neglizhuese dhe mungesës së bashkëpunimit në disa vende ka ndodhur që shkollat në gjuhën amtare të mbyllen.

Ahmet Asani, inxhinier dhe veprimtar nga diaspora thotë se bashkëpunimi çalon jo vetëm në arsim e kulturë, por edhe në ekonomi.

"Diaspora shqiptare nga Kosova e Maqedonia ka nevojë për përkrahjen institucionale te shtetit te Kosovës dhe te Maqedonisë. Jo vetëm kaq, por është kohë e fundit Kosova e Maqedonia duhet të gjejnë forma bashkëveprimi për ta mbështetur diasporën e tyre në drejtim të ruajtjes së gjuhës, kulturës dhe traditave kombëtare. Me politika e projekte të përbashkëta, Kosova dhe Maqedonia mund të ndikojnë shumë pozitivisht në përparimin dhe afrimin e diasporës me shtetet prej nga vijnë pjesëtaret e saj. Mungesa e bashkëpunimit, mungesa e projekteve të përbashkëta, mungesa e dorës institucionale në shkollën plotësuese për gjuhë amtare e në kulturë, ka bërë që në disa vende të mbyllen shkollat për arsim në gjuhen amtare. Por jo vetëm shkolla, arti dhe kultura në diasporë janë ato që duhet t'i preokupojnë dhe angazhojë shtetet tona që t'i dalin në ndihmë diasporës, por është ekonomia-janë remitencat e shumta të cilat duhet gjetur formë që të shndërrohen në fonde investive. Kush më mirë se dy Odat Ekonomike, ajo e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë, në bashkëpunim me përfaqësues e specialistë të ekonomisë e financave nga vendi e diaspora mund ta bëjnë këtë fond të investimeve për të mirën e dy vendeve tona? Nevojitet një platformë e përbashkët bashkëpunimi e bashkëveprimi me diasporën", thotë inxhinier Asani.

GJATË KATËR VITEVE TË ARDHSHME

BEXHETI, REKTOR I UEJL-së

Akademik Abdulmenaf Bexheti është zgjedhur të premten rektor i ri i UEJL-së, pasi morri besimin e Bordit të këtij Universiteti. "Rektori i ri u zgjodh me një shumicë të numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të Bordit, ndërsa procedura zgjedhore u realizua në përputhje me Statutin e UEJL-së", thuhet në njoftimin përkatës. Rektori Bexheti, merr drejtimin e këtij universiteti pas dy mandateve radhazi në këtë post të ish-rektorit Zamir Dika

Shkup, 8 qershor - Universiteti i Evropës Juglindore do të udhëhiqet në katër vitet e ardhshme nga një akademik. Abdulmenaf Bexheti është zgjedhur të premten rektor i ri i UEJL-së, pasi mori besimin e Bordit të këtij Universiteti, sikurse thuhet në njoftimin zyrtar.

"Në një mbledhje të veçantë, me votim të fshehtë, Bordi i Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL), ia dha besimin akademik Abdylmenaf Bexhetit që në katër vitet e ardhshme ta drejtojë Universitetin". Rektori i ri, thuhet më tej, "vjen në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të rektorit të dytë të UEJL, prof. dr. Zamir Dikës, i cili dy mandate radhazi e udhëhoqi me sukses këtë institucion unik të arsimit të lartë në Maqedoni".

Njoftimi për zgjedhjen e akademik Bexhetit në krye të UEJL-së, vëren se "rektori i ri u zgjodh me një shumicë të numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të Bordit, ndërsa procedura zgjedhore u realizua në përputhje me Statutin e UEJL-së" dhe se "konkursi për rektor të ri të UEJL ka qenë i hapur deri më 19 shkurt të këtij viti".

Në Konkurs, thuhet se kanë qenë përfshirë edhe disa kërkesa thelbësore për pozitën e rektorit si: thirrja akademike - profesor ordinar, përvoja menaxheriale (sipas mundësisë e fituar në Universitet), entuziazmi për zhvillimin e misionit të dallueshëm të UEJL, si dhe dhënia përparësi e kandidatëve të cilët i njohin gjuhët që përdoren në nivel të Universitetit: gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze. Krahas Bexhetit, në garën për rektor ishin edhe prof.dr. Blerim Reka dhe prof.dr. Veton Latifi. Mirëpo, Bordi i UEJL-së u përcaktua për kandidaturën e akademik Bexhetit duke i dhënë mbështetje Programit të propozuar prej tij për drejtimin në katër vitet e ardhshme për rektor të këtij institucioni me karakter privat-publik.

Në historinë 18-vjeçare të UEJL-së, akademik Bexheti është rektori i tretë i cili vjen pas prof.dr. Dikës dhe akademik Alajdin Abazit, drejtuesit dhe rektorit të parë i këtij institucioni, i themeluar me iniciativë të komisarit të lartë të OSBE -së për pakicat nacionale, Maks Vander Shtulit. Në vitin 2000 kur edhe u nxit debati për themelimin e UEJL-së, në Maqedoni nuk ishte e lejuar me Ligj themelimi i universiteteve në gjuhën shqipe. Universiteti i Tetovës, i cili ishte themeluar paraprakisht, në vitin 1994, nuk pranohej nga shteti dhe për këtë u nxit nevoja për gjetjen e një zgjidhje që për klasën e atëhershme politike mund të kërkohej në themelimin e një universiteti privat. Për këtë, u ndryshua Ligjit për Arsim të Lartë dhe në mars të vitit 2001 nisi ndërtimi i UEJL-së, i cili nisi punë në vitin akademik 2001/2002, në kampusin universitar në Tetovë. Nga viti akademik 2008/2009 u zgjerua me disa programe studimore edhe në Shkup, ku prej vitit 2012/2013 është i vendosur në objektin te ish- qendrës tregtare "Ura" në hyrje të Çarshisë së vjetër. *(L.P)*

ZËVENDËSKRYEMINISTRI OSMANI PREZANTOI "PLANIN 18"

HAPAT FINALË DREJT ZGJEDHJES SË EMRIT

'Plani 18" ndërlidhet me hapjen e kapitujve 23 dhe 24, që kanë të bëjnë me realizimin e reformave në sistemin gjyqësor, luftën kundër krimit të organizuar, reformat në administratën publike, në media dhe luftën kundër emigrimit jolegal

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 8 qershor - Zëvendëskryeministri i ngarkuar me Çështje Evropiane, Bujar Osmani, ka prezantuar para gazetarëve të premten planin 18 të reformave, duke saktësuar se ky muaj është mjaft i rëndësishëm pasi që do ta përcaktojë të ardhmen e vendit. Ai tha se qëllimet nuk janë vetëm për të mbyllur çështjen e emrit, por të ketë edhe ndryshime thelbësore në vend, dhe se ky është një obligim i marr nga qytetarët e të gjitha bashkësive etnike në vend.

"Jemi në metrat e fundit të një maratone njëzet e pesë vjeçare por nuk mund të parashikoj si do të jetë fundit i epilogët të kësaj maratone.. Gjithmonë pjesa e fundit është më kritike e cila përcakton suksesin ose mos suksesin e bisedimeve. Ajo që mund të them është se të dy palët janë në komunikim të vazhdueshëm dhe se ka vullnet për mbylljen e këtij konteksti 25 vjeçar. Është shimë i rëndësishëm mbyllja e këtij kontesti sepse na hapen dyert për në BE dhe NATO. Të gjithë miqtë ndërkombëtarë na inkurajojnë dhe përpiqen që ta lehtësojnë tejkalimin e kontestit, vlerësoj se është moment ideal që të mbyllet çështja pasi që do ta hapë procesin për NTAO, për bisedime për BE, por kërkoj kuptim që të jemi të kujdesshëm në këtë periudhë dhe të presim se si do të jetë përfundimi në orët dhe ditët në vazhdim", deklaroi Osmani gjatë prezantimit të "Planit 18", përfaqësuesve të sektorit civil, mediave, ekspertëve dhe palëve të tjera të interesuara.

Pas përfundimit të suksesshëm të planit 3-6-9 duke u bazuar në dy parimet kryesore të inkluzivitetit apo gjithëpërfshirës dhe transparencës, theksoi Osmani, na solli deri te rekomandimi i pastër nga Këshilli Evropian për të vazhduar Maqedonia drejt integrimit të vendit në BE.

"Tani kemi sfidën e radhës - 17 qershorin, kur vendet anëtare të KE-së duhet të vendosin që Maqedonia të merr datë për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e Maqedonisë në BE. Qeveria e Maqedonisë është duke punuar në dy trajektoret e veta - mbylljen e çështjeve politike dhe dinamizimin e proceseve të reformave, duke mos e lidhur këtë me një proces teknik të reformimit të shtetit për të marrë një vlerësim pozitiv nga BE, por për shkak të jetës më të mirë të qytetarëve, vende të reja të punës për shtet të së drejtës", deklaroi Osmani. Të gjitha këto, u shpreh Osmani, do të arrihen me realizimin e "Planit 18" që do të vazhdon pas periudhës së përfundimit të projektit 3-6-9. Ai theksoi se në Planin 18, që është vetëm në formë të përpilimit, do të përfshihen të gjitha udhëzimet e raportit evropian

"Do të vazhdojmë me parimet e njëjta gjithë përfshirës, Do të tentojë të takohem edhe të bisedoj edhe me partitë opozitare që edhe ata të bëhen pjesë e procesit për shkak se projekti i BE-së nuk është projekt që mund të ndërlidhet më një Qeveri me një mandate apo një parti por tejkalon kufijtë e mandatave politike për shkak se është përkushtim, ambicie e përpjekjeve qytetare të Republikës së Maqedonisë dhe ne jemi të detyruar si përfaqësues të tyre pavarësisht dallimeve etnike ne të realizojmë ëndrrën e tyre dhe të anëtarësohemi në BE dhe NATO", deklaroi Osmani, i cili njoftoi se e 'Plani 18" ndërlidhet me hapjen e kapitujve 23 dhe 24, që kanë të bëjnë me realizimin e reformave në sistemin gjyqësor, luftën kundër krimit të organizuar, reformat në administratën publike, në media dhe luftën kundër emigrimit jolegal.

ME PADURIM E PRESIM REZULTATIN NGA NEGOCIATAT

Zgjidhja e kontestit shumëvjeçar midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë do të jetë mirë për të dyja shtetet, por edhe për rajonin dhe për gjithë Evropën, deklaroi dje ambasadori i Delegacionit të BE-së Samuel Zhbogar gjatë vizitës në Parkun nacional "Pelister" në Manastir. Sipas ambasadorit Zhbogar, nevojiten durim dhe besim që kjo të ndodhë. "Të gjithë këtu me padurim i presim rezultatet nga negociatat dhe bisedimet shumë intensive që janë në vijim. Mendoj se të dyja palët do të mund të gjejnë zgjidhje cila përveç që për të dy shtetet do të jetë mirë për gjithë rajonin dhe gjithë Evropën. Që kjo të ndodhë ne duhet të kemi durim dhe besim se kjo do të ndodhë", deklaroi Zhbogar, i cili së bashku me ministrin e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor Sadulla Duraku dhe përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Maqedoni Luiza Uinton e vizituan Parkun nacional "Pelister" në Manastir.

VAZHDOJNË PËRPLASJET PËR EMRIN E PARTISË

Apeli i merr të drejtën Kasamit, BESA kthehet në rigjykim

Shkup, 8 qershor - "Jetë për të gjithë", thënia e njohur tashmë e kryeministrit Zoran Zaev, del të jetë e vërtetë vetëm për pushtetin dhe gjithçka që kontrollohet prej tij. Kështu ka akuzuar dje Abdush Demiri, zëdhënës i Lëvizjes BESA së Bilall Kasamit, ndërsa ka informuar se Gjykata e Apelit ka rikthyer në rigjykim kontestin midis dy BESAVE lidhur me emrin e partisë. Bëhet fjalë për vendimin e dy-tre muaj më parë, kur Gjykata Administrative i dha të drejtë BESËS së Kasamit, ndërkohë që tani, Gjykata e Apelit ka rikthyer lëndën në fillim.

"Sot kemi pranuar nga Gjykata e Apelit e Shkupit një vendim skandaloz, i cili nuk ka asnjë përmbajtje juridike, që dëshmon se gjyqësia është akoma e kapur nga pushteti dhe vendimet e saj i sjell përmes imponimeve nga partitë në pushtet. Fakti që Gjykata e Apelit ka pranuar dëshmi të falsifikuara, që nuk janë paraqitur në shkallën e parë, dhe ka pranuar dokumentacion me vulë që Lëvizja BESA e ka shpallur të pavlefshme, dëshmon se ky proces tashmë shndërrohet në proces të pastër politik. Pyesim publikisht gjykatësit e Apelit, se çka i shtyri të marrin një vendim kaq skandaloz në ditën kur votohet Qeveria? A është pikërisht pjesëmarrja në Qeveri e personave të caktuar që ndikoj në vendimin e tyre i cili mund të quhet gjithçka, por jo vendimin i drejtë dhe ligjor. Po ashtu, publikisht e pyesim kryeministrin Zoran Zaev, a duhet që gjithë politikanët të jenë të dëgjueshëm dhe servil ndaj pushtetit që gjykata e Apelit të marrë vendime pro tyre!?", ka thënë Demiri. Jemi të bindur se, ka thënë zëdhënësi i BESËS së Kasamit, jemi në rrugën e drejtë dhe përveç legjitimitetit nga strukturat edhe aspektin legal e kemi të pastër si kristali në favorin tonë.

"Rikujtojmë pushtetin se nëse ndodh precedent që Gjykata të fshije një kryetar partie vetëm se person i paautorizuar ka bërë një kërkesë të tillë, atëherë do inkurajojmë të gjithë të shkojnë në gjykata dhe të kërkojnë të shkruhen si kryetar të LSDM-së pasi që një praktikë e tillë po vendoset nga pushteti që udhëheq LSDM. Edhe përkundër këtij vendimi skandaloz, rikujtojmë se Lëvizja Besa jemi ne dhe se personi i

vetëm i autorizuar në gjykatë është kryetari Bilall Kasami, dhe çdokush që do tentojë që të anashkalojë këtë fakt, do të përballet deri në fund me procedurat e nevojshme para organeve të drejtësisë.

Po ashtu njoftojmë se prej sot kemi nisur edhe procedura juridike për disa persona që janë nënshkruar në emër të Lëvizjes BESA dhe kanë falsifikuar vulën e partisë", ka thënë Demiri, duke shtuar se tashmë është njoftuar edhe faktori ndërkombëtar për, siç ka thënë ai, këtë padrejtësi që po i bëhet Lëvizjes BESA.

Shkup, 120 shoferë sanksionohen për tejkalim shpejtësie

Gjithsej 120 shoferë në Shkup ngasin me shpejtësi më të madhe nga e lejuara në 24 orët e fundit, tregojnë të dhënat nga buletini ditor i SPB-së Shkup. Trembëdhjetë shoferë kanë përdorë telefon celularë derisa ngasin, ndërsa në dritë të kuqe në udhëkryq kanë kaluar tetë shoferë. dy nuk kanë ndaluar në kalimin për këmbësorë që t'u japin përparësi këmbësorëve, një nuk ka dhënë përparësi për parakalim, ndërsa dy nuk kanë dhënë përparësi për kalimin e automjetit në udhëkryq. Në 24 orët e fundit në rajonin e kryeqytetit kanë ndodhur gjithsej 11 aksidente prej të cilave dy lëndime të rënda trupore kanë marrë katër persona, ndërsa në pesë lëndime të lehta trupore kanë marrë tetë persona. Në katër aksidente është shkaktuar dëm material. Nga trafiku janë përjashtuar 14 shoferë sepse kanë drejtuar automjetin para se ta marrin të patentën, tre shoferë fillestarë, si dhe 13 kanë drejtuar automjetin me leje qarkullimi të skaduar dhe tre shoferë automjetet e të cilëve kanë qenë të parregullta. Për parkim të parregullt janë shqiptuar 251 masa, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë larguar 70 automjete.

RIZGJEDHJA E GJYKATËSVE VETËM ME STANDARDE EVROPIANE

GJYKATËSIT I NJOHIN KOLEGËT E KORRUPTUAR

Kushtetuta aktuale dhe statusi ligjore i gjykatësve, siç theksojnë nga Instituti për hulumtime dhe analiza juridike, e pamundësojnë realizimin e procesit të rizgjedhjes së gjykatësve në Maqedoni

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 8 qershor - Ndonëse kryeministri Zoran Zaev, para se ta marrë pushtetin paralajmëroi rizgjedhje të plotë të gjykatësve, megjithatë një proces i tillë në Maqedoni deri më sot nuk u realizua. Madje, sipas ekspertëve që merren me monotorimin e reformave në sistemin e drejtësisë, një procedurë e tillë as që pritet të ndodhë. Në hulumtimin e publikuar së fundmi nga Instituti për analiza juridike, thuhet se Maqedonia ballafaqohet me një numër të vogël të gjykatësve të korruptuar dhe politikisht të motivuar. Zgjidhja e këtij problemi, siç thuhet në këtë hulumtim, i cili mbështetet edhe në rekomandimet e Raportit të Pribes për vitin 2017, duhet të realizohet përmes hetimeve që do të vërtetojnë përgjegjësi individuale të gjykatësve.

"Në rast se konstatohet shkelje ligjore nga gjykatësi i caktuar, atëherë i njëjtit duhet të përjashtohet nga mundësia që në çfarëdolloj mënyre të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë. Nëse shihet kronologjikisht, në Maqedoni rizgjedhja e gjykatësve si masë reformuese ka qenë e zbatuar vetëm në kushte të ndryshimeve të sistemeve politiko-shoqërore. Fillimisht, rizgjedhja e gjykatësve është zbatuar kur është themeluar sistemi gjyqësori i vendit tonë, pra në vitin 1944 kur komunizmi ka qenë i vendosur si veprim politik. Pastaj, hera e dytë dhe e fundit e rizgjedhjes së gjykatësve në Maqedoni është realizuar në vitin 1995, disa vite më vonë pas vendosjes së demokracisë si sistem politik. Nëse merren parasysh zhvillimet e viteve të fundit dhe ndryshimin e pushtetit, është e qartë se këto lëvizje nuk i ngjajnë fare atyre të dekadave të mëhershme, respektivisht lufta aktuale zhvillohen kundër gjykatësve politikisht të korruptuar", thuhet në hulumtimin e Institutit për analiza juridike.

Kushtetuta aktuale dhe statusi ligjor i gjykatësve, siç theksojnë nga Instituti për hulumtime dhe analiza juridike, e pamundëson realizimin e procesit të rizgjedhjes së gjykatësve në Maqedoni.

Vlerësim i autorëve të këtij hulumtimi, Lidija Stojkova-Zafirovska dhe Zharko Haxhi Zafirov është se në rast se krijohen kushte për realizimin e rizgjedhjes së gjykatësve, atëherë atij proces duhet ti paraprijë ndërtimi i një sistemi transparent dhe objektiv konform standardeve evropiane.

Tutje, hulumtimet dhe analizat e realizuar nga ky Institut, potencojnë se fillimi i operacioneve të tilla, fushëveprimi i të cilëve është tepër i gjerë lë të hapur mundësinë dhe rrezikun e instalimit të "gjykatësve", të ri të cilat do ti shërbejnë një elite të caktuar politike.

"Pjesa dërmuese e gjykatësve, të cilat gjatë kohës së fundit i kemi kontaktuar shprehen qartë se i dinë cilët janë kolegët e tyre të korruptuar, gjegjësisht kush janë ato gjykatës që e kanë keqpërdorur pozitën e tyre në shërbim të një subjekti të caktuar politik apo personi dhe më pas të njëjtit janë avancuar në hierarki. Kur flasim për rizgjedhjen e plotë të gjykatësve gjykatësit e Gjykatave të Apelit në Shkup, Shtip, Manastir dhe Gostivar, janë të pajtimit se një procedurë duhet të ndodhë, megjithatë me paraprakisht duhet të caktohet kriteret e qartë dhe mënyrë transparente", thuhet mes tjerash në publikimin e Institutit për të drejtat e njeriut.

Një pjesë e ndryshimeve të Ligjit për gjykatës dhe Këshillin Gjyqësor që u miratuan javë më parë, parashohin përgjegjësi disiplinore për gjykatësin nëse ai në mënyrë të pajustifikueshme nuk cakton seancat gjyqësore, e prolongon seancë apo nuk e shqyrton lëndën e cila mund të vjetrohet. Tutje, përgjegjësi disiplinore është paraparë edhe për kryetarin e gjykatës, i cili nëse në mënyrë jo të duhur do t'i zbatojë dispozitat apo do ta keqpërdor sistemimin e vjetor të gjykatësve, ai mund të shkarkohet. Ligji për gjykata dhe ai për Këshill Gjyqësor, po ashtu pritet të ndryshohet dhe plotësohen në periudhën që vijon.

NIS EVIDENTI I PERSONAVE PA DOKUMENTE

600 persona pa shtetësi

Shkup, 8 qershor - Nevojë për ndryshim të zgjidhjeve të caktuara ligjore, thjeshtësim të procedurave për regjistrim në librin amë të të lindurve, bashkëpunim ndërinstitucional dhe punë më efikase në terren për zbulim dhe zgjidhje të statusit të personave të cilët janë pa dokumente personale dhe shtetësi, konstatuan një pjesë e nxënësve në debatin e djeshëm në të cilin u prezantua edhe "Analiza e kornizës juridike e lidhur me regjistrimin amë dhe qytetar lidhur me pengimin e pashtetësisë".

Profesori Borçe Davitkovski, i cili është autor i saj, theksoi se për zgjidhje të këtij problemi nevojiten ndryshime ligjore, regjistrim të të gjithë personave të cilët janë pa shtetësi, por edhe në rrezik nga pashtetësia, procedurë e posaçme për konfirmim të statusit të pashtetësisë, si dhe trajnime për ngritje të vetëdijes tek popullata që është në rrezik nga pashtetësia. "Këta persona duhet të fitojnë status juridik të qytetarëve. Ata tani janë masë amorfe, të cilët nuk ekzistojnë, janë të paemëruar. Nuk ka dokumente personale. Ka persona të cilët kanë identitet, por, nuk kanë shtetësi, por edhe persona të cilët nuk kanë as identitet, as shtetësi. Duhet të bëhen përpjekje që këta persona të bëhen qytetarë dhe të mund t'i shfrytëzojnë të gjitha të drejtat", tha Davitkovski. Përfaqësuesi i UNCHR-së në Maqedoni, Dejan Kladarin, konsideron se problemi me apatridët është i zgjidhshëm dhe se për këtë nevojitet qasje sistematike. Nevojiten ndryshime ligjore, lehtësim të procedurave administrative të cilat do të mundësojnë që në një të ardhme të afërt të zgjidhet problemi.

Paralelisht me këtë, shtoi Kladarin, duhet të punohet edhe në terren në bashkëpunim me sektorin joqeveritar që këta persona të identifikohen dhe të ndihmohen që ta zgjidhin statusin e tyre. Përfaqësuesi i OSBE-së në Maqedoni, Xhef Goldstajn, theksoi se ky është problem i më shumë gjeneratave, për shkak se, siç tha, personi i cili nuk ka dokumente nuk mund t'i regjistrojë, as fëmijët e tij edhe pse është lindur në vend. Posaçërisht e rëndësishme, sipas tij, është puna në terren.

"Konsiderojmë se është shumë e rëndësishme që Qeveria të ketë bashkëpunim me OJQ nga bashkësitë në të cilat ka shumë persona të paregjistruar, për shkak se nëse nuk e di se si mund të regjistrohen, nuk mund të zgjidhet problemi edhe pse ka super ligje", tha Goldstajn. Jovana Trençevska, sekretare shtetërore në MPPS, theksoi se posedimi i dokumenteve personale është kyçe që një person të mund t'i realizojë të drejtat e tij, në procedura para institucioneve kompetente, qendra për punë sociale, institucionet shëndetësore, agjencitë për punësim, institucionet arsimore, por edhe që t'i realizojnë të drejtat themelore të njeriut. Për këtë arsye, nevojitet zgjidhje e këtij problemi, për çka është angazhuar edhe Qeveria. Ajo informoi se deri tani janë identifikuar rreth 600 persona për të cilët është realizuar verifikim në bazën për numër amë të qytetarit, si dhe librat amë të të lindurve. Madje, është konfirmuar se një pjesë e tyre tanimë janë identifikuar në librat amë, por nuk kanë certifikata, disa janë lindur në spital, por nuk u është caktuar emri personal, ndërsa një pjesë në kushte shtëpiake, por asnjëherë nuk është paraqitur lindja e tyre. Sipas saj, nevojitet ndryshim i ligjeve për procedurë jashtëgjyqësore, dhe për evidentim amë në drejtim të hapjes së regjistrit të posaçëm për persona të cilët nuk kanë regjistrim të qytetarëve dhe numër të posaçëm regjistrimi nga karakteri i përkohshëm deri në regjistrim në librin e të lindurve. Prezantimi i analizës ishte në organizim të misionit të OSBE-së në Shkup, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe Përfaqësisë së UNCHR-së në Shkup. *(E.H)*

POLITIKAT ARSIMORE NË DREJTIM TË GABUAR

MUNGESA E MJESHTËRVE, PROBLEM SHOQËROR

Sistemi arsimor në Maqedoni fare pak prodhon kuadër të trajnuar për kërkesat e biznesit dhe industrisë në shtet dhe janë shumë të dobëta lidhjet midis nevojave të biznesit, tregut të punës dhe arsimit profesional të mesëm

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 8 qershor - Sistemit të mesëm profesional në Maqedoni i mungon praktika më e madhe që do të ofrojë kuadër të gatshëm që menjëherë të inkuadrohet nesër në procesin e punës. Për pasojë ky sistem fare pak prodhon kuadër të trajnuar për kërkesat e biznesit dhe industrisë në shtet. Madje në nivel të gjithë shtetit janë shumë të dobëta lidhjet midis nevojave të biznesit, tregut të punës dhe arsimit profesional të mesëm. Shpesh edhe profilet arsimore nuk i përgjigjen nevojës së kompanive private, ndërsa nxënësve iu mungon edhe praktika profesionale përkundër njohurive teorike. Kjo edhe për shkak se arsimi i mesëm profesional nuk ofron mjaftueshëm shkathtësi për nxënësit të cilët, jo rrallë, kanë vështirësi që pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional të inkuadrohen në tregun e punës.

SHUMË TEORI, PAK PRAKTIKË!

Edhe një pjesë e bizneseve në vend thonë se nevojitet të rritet më shumë ndërlidhja e shkollave të mesme profesionale dhe kompanive private që do të sjellë dobi për të tria palët, si për nxënësit, arsimin e mesëm, ashtu edhe për biznesin.

"Bashkëpunimi me shkollat e mesme ekonomike dhe të tregtisë për momentin rrjedh vetëm në mbajtjen e ligjëratave profesionale nga ana e një pjese të stafit menaxhues të kompanisë Dauti Komerc, ndërsa mungon në aspektin e kryerjes së praktikës së paku për një gjysmëvjetor. Ne si biznes jemi të hapur për një bashkëpunim të tillë, dhe në rast se do të vinin nxënësit në praktikë me siguri se një numër i caktuar i tyre nesër edhe do të mund të konkurronin për ti punësuar në veprimtarinë tonë", thotë pronari i kompanisë Dauti Komerc, Xhemali Dauti.

Në ndërkohë, nga agjencitë e punësimit thonë se në nivel të tërë Maqedonisë, një problem madhor është jo vetëm mungesa e praktikës për shkollat e mesme profesionale, por edhe regjistrimi shumë i vogël i gjysmë-maturantëve në shkollat e mesme profesionale, që pamundëson edhe krijimin e një paralele të plotë për një profesion të caktuar.

"Tregu i punës në Maqedoni karakterizohet me më shumë dobësi siç janë mungesa e praktikës më të madhe për gati të gjitha drejtimet në shkollat e mesme dhe shkollat e mesme profesionale, si dhe mungesa e mjeshtërve që dalin nga bankat shkollore për shkak të interesimit shumë të dobët për regjistrim në shkollat e zanatit. Vetëm në vitin shkollor 2015-2016 nëse i referohemi të dhënave zyrtare statistikore në shkollat e mesme profesionale që do të duhej

XHEMAL DAUTI

Ne si biznes jemi të hapur për një bashkëpunim të tillë, dhe në rast se do të vinin nxënësit në praktikë, me siguri se një numër i caktuar i tyre nesër edhe do të mund të konkurronin për ti punësuar në veprimtarinë tonë

nesër ti ofrojnë tregut , profile të ndryshme të punëtorëve në industri, janë regjistruar vetëm tre për qind e totalit të semi-maturantëve. Për çfarë praktike flasim atëherë nëse në një klasë prej 15 nxënës mësojnë tre nxënës për saldator, tre nxënës për bravë-punues, apo katër nxënës të profileve të ngjashme , ku nuk mund të krijohet as një grup serioz për praktikë", thotë Rade Nenadiq, drejtor i Agjencisë për punësime të përkohshme "Partner".

MODELI GJERMAN: EDHE NË SHKOLLË EDHE NË KOMPANI

Nga ana tjetër në shtator të vitit të kaluar filloi projekti trevjeçar për arsimin dual profesional sipas modeli gjerman. Projekti pritet të ofrojë zgjidhje të caktuar të mungesës së kuadrit të specializuar, për shkak se sistemi arsimor në Maqedoni fare pak prodhon kuadër të trajnuar për kërkesat e biznesit, dhe sidomos për mbi 200 kompani me kapital gjerman në Maqedoni Në një pjesë të shkollave në vend do të zbatohet trajnimi dual, që nënkupton në mënyrë paralele arsimin edhe në ndonjë shkollë edhe në ndonjë kompani, ose nënkupton ndërlidhje të teorisë dhe praktikës. Me këtë, nxënësit, që nga shkolla e mesme do të jenë gati të punësohen në ndonjë kompani.

"Maqedonia është zgjedhur për shkak të nevojave të kompanive gjermane automobilistike për fuqi të kualifikuar pune. Qëllimi është të kënaqen nevojat konkrete të kompanive gjermane dhe jo ti ofrohen këshilla shteteve se çfarë sistem arsimor ju nevojitet", thonë udhëheqësit e projektit. Me sistemin për arsim dual do të fitohet arsim i pranuar ndërkombëtarisht me perspektivë të mirë në tregun vendor të punës.

Ndryshe, në Maqedoni punojnë mbi 200 kompani me kapital gjerman që punësojnë 15 mijë punëtorë që kanë vështirësi të gjejnë punëtorë të specializuar, për shkak se sistemi aktual arsimor nuk ofron mjaftueshëm aq punëtorë sa kërkon tregu i punës.

Donacion çek prej një milionë eurosh për policinë

Shkup, 8 qershor - Ministria e Punëve të Brendshme dje mori donacion të ri në lartësi prej një milion eurosh nga Republika Çeke për rritjen e kapaciteteve të policisë së Maqedonisë, gjegjësisht për blerjen e pajisjeve teknike për ballafaqim me pasojat nga kriza emigruese. Marrëveshjen për donacion në Shkup e nënshkroi ministri Oliver Spasovski dhe ambasadori çek në Maqedoni, Mirosllav Toman. Ministri Spasovski pas nënshkrimit, tha se ky është donacioni i tretë nga MPB-ja çeke dhe Qeveria e Republikës Çeke nga fillimi i krizës emigruese, që në përgjithësi me të sotmen është në lartësi prej rreth tre milion euro. "Si rezultat i bashkëpunimit në këtë projekt të filluar në vitin 2016 MPB-ja çeke deri në fillimin e gushtit të vitit 2018 do të dërgojë gjithsej 734 nëpunës policorë çekë në territorin e Republikës së Maqedonisë të sistemuar në 19-të kontingjente, që së bashku me nëpunësit tonë policorë të bëjnë mbikëqyrjeje dhe kontroll të kufirit tonë jugor", tha Spasovski. Ambasadori çek Toman, pas nënshkrimit shprehi bindjen se bashkëpunimi do të vazhdojë, posaçërisht në fushën e këmbimit të përvojave mes kolegëve prej të dy ministrive. Në pyetjen e gazetarëve nëse Maqedonia është e gatshme për fluks të ri refugjatësh, ministri Spasovski, tha se është shumë me rëndësi përmes qasjes strategjike të BE-së dhe vendeve anëtare edhe vendeve nga rajoni të ketë qasje koordinuese dhe të ndihmohet në uljen e të gjitha efekteve negative. Ai përmendi se tashmë është harmonizuar dhe para nënshkrimit marrëveshja me FRONTEKS-in, e cila do të mundësojë mbrojtje të kufirit të Maqedonisë.

Edhe katër ditë për aplikim për subvencione bujqësore

Shkup, 8 qershor - Më 12 qershor të këtij viti përfundon afati për parashtrimin e kërkesave për subvencione për prodhim e bimëve dhe të kafshëve, kumtoi drejtori i Agjencisë Pagesore, Nikollçe Babovski. Deri më tani, tha Babovski në konferencë për shtyp, kanë aplikuar 64.448 bujq, por pritet numri të rritet edhe për 7000 deri në 8000. Ai u bëri thirrje bujqve të aplikojnë me kohë që sa më shpejt të përpunohen kërkesat dhe mjetet të paguhen.

Drejtori paralajmëroi se nesër do të publikohet thirrja publike për parashtrimin e kërkesave për subvencione në peshkatari, gjegjësisht për mbështetjen e pikave të reja për peshkim dhe të rehabilitohen ato ekzistuese, përkujtoi, dhe shpallja për investime në ekonominë bujqësore për çfarë janë siguruar subvencione përmes Programit për zhvillim rural. Aplikimet për subvencione mund të parashtrohen në mënyrë elektronike, ndërsa nëse bujqve u nevojitet ndihmë në plotësimin e dokumentacionit, mund të drejtohen në Agjencinë Pagesore.

Agjencia Pagesore në vit përpunon prej rreth 150.000 - 1600.000 kërkesa për subvencione, ndërsa aplikime parashtrojnë më shumë nga 70.000 fermerë. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve, drejtori i Babovskit informoi se rezultatet nga kontrollet të ekipeve të pavarura të ekspertëve nga BE-ja lidhur me efektin e deritanishëm nga subvencionet e bujqve priten për një deri në 1.5 muaj.

VAZHDON DEBATI PËR SUBVENCIONIMIN E SHTYPIT TË SHKRUAR

SUBVENCIONIMI I GAZETAVE, KËRKESË E TË GJITHËVE

Invazioni i portaleve, orientimi i reklamave të bizneseve drejt internetit në Google, Facebook, Apple dhe Tuiter nga njëra anë si dhe rritjen enorme të shpenzimeve për letrën e shtypit dhe rritjen e shpenzimeve për distribuimin e gazetave nga ana tjetër, ishin ndër arsyet kryesore se pse mediat e shkruara kanë kërkuar nga Qeveria për subvencionimin prej 50 për qind të shtypit dhe distribumit

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 8 qershor - Mediat e shkruara në Maqedoni, si ato maqedonase ashtu dhe ato shqipe, janë në gjendjen e tyre më të keqe, duke shtruar dilemën nëse duhet të mbyllen pjesa më e madhe e tyre apo të sigurohet mbijetesa e tyre përmes subvencionimin të shtypit dhe distribuimit nga an e Qeverisë. Ky ishte boshti kryesor i diskutimit të premten gjatë debatit "drejt politikave publike për subvencionimin e mediave", organizuar nga organizatat joqeveritare "Civila Mobitas" dhe Qendra për Zhvillimin e Mediave. Siç u cek nga pjesëmarrësit e debatit, invazioni i portaleve nga njëra anë dhe nga ana tjetër orientimi i reklamave të bizneseve drejt internetit në Google, Facebook, Apple dhe Tuiter, ka zvogëluar në masë të madhe te hyrat nga reklamat në mediat e shkruara saqë ka ndikuar në uljen e numrit të punëtorëve, por dhe mbylljen e disa gazetave ditore kohë më parë. Drejtori i gazetës KOHA, Lirim Dullovi, njëherësh dhe kryetar i Asociacionit për Mbrojtjen e Mediave të Shkruara në Maqedoni, përmendi rritjen enorme të shpenzimeve për letrën e shtypit dhe rritjen e shpenzimeve për distribuimin e mediave të shkruara, ndër arsyet kryesore pse kanë kërkuar nga Qeveria për subvencionimin prej 50 për qind të shtypit dhe distribuimit. "Përveç ikjes së reklamave drejt internetit, prej janarit e këndej kemi rritjen e shpenzimeve për letrën prej 18 për qind, ndërsa pritet të rritet deri në 30 për qind muajve të ardhshëm. Plus kemi edhe rritjen e çmimit të naftës që lidhet direkt me rritjen e shpenzimeve për distrubuim, kjo ka bërë që ne të arrimë në përfundim se duhet gjetur një zgjidhje për gjendje e keqe të mediave të shkruara. Si organizatë, kemi bërë kërkesë drejt Qeverisë për të na ndihmuar në mbulimin harxhimeve për shtyp rreth 50 për qind, dhe po aq për mbulimin e harxhimeve për distribuim", tha Dullovi. Ai u shpreh nga Qeveria kanë gjetur mirëkuptim, por duhet diskutuar modelin më të duhur të financimit. "Ajo që duhet të shtrojmë para juve është mënyra e rregullimit ligjor, të kemi Ligj të veçantë për subvencionimin e mediave apo kjo të bëhet përmes ndryshimeve të Ligjit aktual për media", tha Dullovi. Kur jemi tek mediat shqipe, ai përmendi se është kërkuar që mediat shqipe dhe ato të pakicës të ndihmohen me plus 20 për qind, për faktin se siç tha Dullovi, kështu kanë rekomanduar në vijimësi shumë organizma ndërkombëtarë, si raporti i Pribes, Rekomandimet e UNESKO-s të vitit 2012, rekomandimet e OSBE-së gjatë Konferencës në Strugë të vitit 2014, rekomandimet e Komisionit Evropian të vitit 2917. Ai bëri të ditur se kanë kërkuar po ashtu nga Qeveria në ndërmarrjet publike ku ajo është aksionare, si në Telekom dhe ndërmarrjet e tjera, 10 për qind e reklamave në mënyrë obligguese të shkojnë për shtypin e shkruar. Kjo, siç tha ai, do të krijonte stabilitet më afatgjatë të mediave të shkruara. Biljana Mlladenva nga javorja Fokus shtroi problemin e funksionimit të portaleve që krijojnë opinion dhe marrin reklama të privatëve pa u regjistruar dhe pa u rregulluar me Ligj. "Së pari, gjithë këto portale të regjistrohen dhe më pas të rregullohen me Ligj, dhe të definohen cilat prej tyre informojnë për ngjarje ditore dhe kanë në plan interesin publik dhe çfarë mund të përfitojnë dhe si nga bizneset. Shumica e portaleve që japin lajme në vendet e BE-së janë të rregulluara me Ligj, e njëjta duhet të ndodh edhe tek ne", tha Mlladenova. Ndërkaq Zoran Dimitrov po nga javorja Fokus tha se shumica e vendeve perëndimore e subvencionojnë shtypin e shkruar dhe siç tha ai, ka pasur efekt pozitiv. "Në SHBA, ende libri i shkruar është në rend të parë edhe përkundër digjitalizimit të shumicës së librave, që do të thotë se leximi mbetet përsëri në plan të parë. Edhe tek gazetat interesi është në rend të parë publik, dhe kjo është parë drejt nga shumë vende si Franca, Suedia dhe Gjermania dhe kanë pasur efekt pozitiv në subvencionimin e shtypit të shkruar. Kur jemi tek kriteret, duhet dhënë përparësi gazetarisë hulumtuese, aspektit profesional të shkrimit dhe informimit objektiv", tha Dimitrov.

SIPAS TË DHËNAVE PËR PARAQITJEN E PROVIMEVE

Për gjashtë vite, 4000 maturantë më pak!

Në Maqedoni po bie në mënyrë permanente numri i nxënësve në shkollat e mesme dhe kjo vërtetohet edhe me numrin e atyre që në përfundim të këtij shkollimi japin provimet Maturës Shtetërore. Këtë vit ka 15.265 kandidatë apo rreth 1200 më pak se vitin e kaluar. Ndërkaq, ende më e thellë bëhet kjo rënie nëse i krahasojmë numrat me vitin 2012, kur në afatin e qershorit provimet e maturës shtetërore i kishin paraqitur rreth 19 mijë nxënës

Koha — Laura PAPRANIKU

Shkup, 9 qershor - Arsimi i mesëm i obligueshëm nga viti 2007, siç edhe pritej, rriti në mënyrë permanente numrin e nxënësve në këtë nivel shkollimi. Por kjo ndodhi vetëm për pak vite, deri në vitin shkollor 2010/2011, pra deri kur në këtë nivel shkollimi u përfshinë 100 për qind e popullatës nga 15 deri në 19 vjet. Menjëherë pas kësaj filloi rënia, pasi numri i nxënësve që ndjekin shkollimin e mesëm në Maqedoni iu dorëzua dukurisë së rënies së përgjithshme të numrit të popullsisë së kësaj moshe e që është rezultat i faktorëve social e demografik, sikurse janë shkalla e natalitetit apo edhe migrimet e shumta. Rënia e viteve të fundit, padyshim se është reflektuar edhe në numrin e nxënësve që kryejnë arsimin e mesëm dhe që ka tregues përkatës numrin e atyre që paraqesin provimet e Maturës Shtetërore. Dallimi në numrin e atyre që paraqesin Maturën Shtetërore është dukshëm i madh. Nga viti në vit, ai numër bie për rreth 1000 maturantë, herë më shumë e herë më pak, por që në harkun kohor nga 2012-ta deri vitin 2018, ka një rënie prej gati 4000 nxënës. Bazuar në të dhënat e Qendrës së Provimeve Shtetërore (QPSH), këtë vit provimet e Maturës Shtetërore i kanë paraqitur vetëm 15.256 maturantë, që afatin e qershor. Në harkun kohor prej gjashtë viteve, ky numër shënon rekordin rënie. Është për rreth 1200 nxënës më pak edhe se numri i maturantëve të vitit të shkuar, nëse kemi parasysh faktin se për afatin e qershorit provimeve të Maturës Shtetërore 2017 iu nënshtruan 16.426 nxënës. Në vitin 2014 kishim 18.000 maturantë, ndërsa në vitin 2012, ai numër ishte në rreth 19.000 maturantë.

Ajo që nuk ka ndryshuar gjithë këto vite është dëshira për të mos iu nënshtruar verifikimit të dijeve nga lënda e matematikës. Këtë vit, vetëm 1926 nxënës kanë paraqitur këtë lëndë për provim mature, të tjerët (13.330) kanë zgjedhur gjuhët e huaja, kryesisht gjuhën angleze. Përveç provimet të gjuhës amtare, apo gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi, në përfundim të arsimit të mesëm, nxënësit duhet t'ju nënshkruhen verifikimit të diejve edhe në dy lëndë të tjera të cilat mund ti zgjedhin nga lista përkatëse. Zgjedhja e parë bëhet mes matematikës dhe gjuhës së huaj që nxënësit e kanë ndjekur të plotë apo përgjatë gjithë viteve të shkollimit. Ndërsa zgjedhja e dytë bëhet mes historisë, fizikës, kimisë, biologjisë, filozofisë, estetikës dhe biznesit. Të tria këto provime kanë vlerësim ekstern, pra notat caktohen nga një Komision i jashtëm, i cili formohet nga ana e QSHP-së. Është edhe një provim i katërt, por që nuk ka vlerësim ekstern dhe që vlerësohet nga një Komision brenda shkollës për Punën Projektuese. Të shtunën, më 9 qershor, nxënësit do të japin provimet e gjuhës amtare, respektivisht të lëndës në të cilën kane zhvilluar mësimi. Për gjuhën dhe letërsinë maqedonase janë paraqitur 10.119 nxënës, për gjuhën dhe letërsinë shqipe 4474, për gjuhën turke 374 dhe anoj për gjuhën serbe, pasi paralelet e mesme në këtë gjuhë. Provimet e matematikës dhe të lëndës së tretë do të mbahen më 11 dhe 13 qershor.

Banesat nuk do të lirohen, tatimi mbetet 5 për qind

Shkup, 8 qershor - Oda ndërtimore pranë Lidhjes së Odave Ekonomike (LOE) e përshëndet vendimin qeveritar që Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) gjatë shitjes së parë të banesave të mbetet 5 për qind deri në vitin 2023 dhe paralajmëron vazhdim të atyre të përhershme, si dhe investime të reja. Sipas anëtarëve të Odës, hapësirë për ndërtim ka, ndërsa çmimet e banesave nuk do të zvogëlohen, por nuk ekziston mundësi as për rritje në afatin më të shkurtër.

"E përshëndesim vendimin qeveritar për vazhdim të masës me të cilën plotësisht do të stabilizohet sektori i ndërtimit të lartë, do të vazhdojnë të gjitha investimet e ndërprera, por edhe do të fillojnë të reja. Nga kjo, përveç firmave ndërtimore, përfitim do të kenë edhe blerësit e banesave, si dhe mbi 20 degët e lidhura me ndërtimtarinë", tha në konferencën e sotme për shtyp kryetari i Odës ndërtimore të LOE-së, Ivica Jaqimovski. Ai apelon të vazhdojë realizimi i investimeve të kapitalit, rrugëve, hekurudhave, gazifikimi, ujësjellësi dhe rrjeti i kanalizimit..., sepse vetëm ashtu mundet, vlerësoi Jaqimovski, të ketë rritje ekonomike. Jaqimovski pret që në disa muaj të ardhshëm trendi në ndërtimet e ulëta të bëhet pozitiv. Për realizimin e tërësishëm të projekteve të parashikuara në ndërtimtari, ndërtime të ulëta dhe të larta, është e domosdoshme, plotësoi, të respektohen planet dinamike. Në lidhje me ndërtimin e banesave, Jaqimovski tha se të domosdoshme janë planet e reja urbanistike për ndërtim planor dhe standard më të mirë jetësor. Çmimet e banesave lëvizin prej 1000 deri në 1300 euro për metër katror në rajonet qendrore të qytetit dhe prej 650 deri në 900 euro në periferi.

LIBERALIZIMI I TREGUT ENERGJETIK

I PAQARTË MBETET ÇMIMI

Me liberalizimin e tregut energjetik, parashikohet që për nëntë muaj, qytetarët rrymë të mund të blejnë nga më shumë kompani, ngjashëm me ofertat në tregun e telekomunikacionit



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 8 qershor - Prej muajit mars të vitit të ardhshëm amvisëritë në Maqedoni do të mund të zgjedhin kompaninë prej të cilës do të blejnë rrymë. Me ligjin e ri për energjetikë krahas EVN-së, amvisëritë me energji do të mund ti furnizojnë 28 kompani të tjera që kanë licencë për këtë gjë. Me liberalizimin e tregut energjetik parashikohet, që për nëntë muaj, qytetarët rrymë do të mund të blejnë rrymë nga më shumë kompani ngjashëm me ofertat në tregun e telekomunikacionit. Gjithashtu ligji parashikon që për ata qytetarë që nuk do të zgjedhin furnizuesin, me energji elektrike do ti furnizojë i ashtuquajturi "furnizues universal", si kompani që do të zgjidhet në ankand publik në çdo pesë vite. Në këtë mënyrë garantohet se asnjë konsumator nuk do të mbetet pa rrymë. Njëherësh furnizuesit me rrymë do të obligohen që në ofertat e tyre të përfshijnë edhe tarifat e ndryshme të lira ngjashëm me përvojën e deritanishme të shfrytëzimit të energjisë elektrike.

PRITET TË KETË ÇMIMIN MË KONKURRUESE

Nga ana tjetër , zyrtarët e Qeverisë thonë se është herët që tani të flitet se a do të lirohet apo shtrenjtohet çmimi i energjisë elektrike në vitin 2019. " Askush nuk mund të thotë në mënyrë të saktë se a do të jetë çmimi i rrymës më i lirë në të ardhmen, për shkak se edhe rryma është prodhim i bursës ngjashëm me çdo prodhim tjetër. Kjo është njejtë sikur të parashtroni pyetjen se a do të jetë nafta apo metalet më të lira. Gjithashtu me legjislacionin e ri, çmimi i energjisë elektrike, çdo herë do të jetë më i volitshëm në raport me atë që e ofronte ligji ekzistues.", thotë zëvendës kryeministri për çështje ekonomike, Koço Angjushev .

Sipas tij, kompania që do të fitojë tenderin qeveritar dhe do të bëhet furnizues universal , do të duhet të mbrojë qytetarët nga luhatjet eventuale të mëdha në treg, andaj edhe në shtatë vitet e para , afër 80 për qind e prodhimtarisë vendore të rrymës, apo e Elektranave të Maqedonisë do të shkojë për amvisëritë dhe nuk do të importohet rrymë e shtrenjtë prej jashtë.

Njëherësh kompanitë do të duhet që harxhimet e tyre ti përfshijnë në ndonjë margjinë mbi çmimin furnizues të rrymës, prej nga do të rrjedh edhe konkurrenca e tyre. Ligji i ri për energjetikë stimulon kompanitë e orientuara ndaj tregut që në bazë konkurruese të zvogëlojnë harxhimet joproduktive thekson më tej Angjushev. Në ndërkohë, pritet që në vitet e ardhshme të ketë çmimin më konkurruese të rrymës që do ta prodhojnë Elektranat e Maqedonisë, përdorimin më të madh të gazit në amvisëri dhe industri, paraqitjen e kompanive të reja që do të ofrojnë rrymë për shitje, që të gjithë lojtarët në tregun energjetik të garojnë me oferta më të mira për konsumatorin.

PËRVOJA KROATE

Përvojat kroate e cila para gjashtë vitesh që liberalizoi tregun energjetik, tregojnë se çmimi fiks i kompanisë shtetërore të rrymës HEP apo Elektro-ekonomisë Kroate ofron është 0.3495 kuna për kilovat orë, në kushte kur për një euro paguhen shtatë kuna. Kjo kompani mban 91 për qind të tregut. Kompania RVE energji që mban 5 për qind të tregut ofron çmim prej 0.3803 kuna për kilovat orë , ndërsa në treg ekzistojnë edhe tre ofertues të tjerë më të vegjël.

Ofertat në treg të HEP janë çmimi fiks për tërë kohën e furnizimit , ndërsa RVE energji ofron çmime në varësi prej gjatësisë së kontratës. HEP ofron që vetë konsumatorët ta lexojnë konsumin e rrymë duke i liruar prej çmimit prej afër 1 euro plus TVSH, ndërsa ofron edhe kursime shtesë prej 2.7 për qind përmes klubit të tyre. RVE energji ofron lirim prej 10 për qind në tre vitet e para , dhe lirim prej 7 për qind në dy vitet e para për ofruesin universal, 2 për qind shtesë për marrëveshjen onlajn, një muaj gratis në 12 muaj për çdo konsumator të ri që ju e sillni në rrjet, dhe konsultime falas për kursimet në amvisëri. Gjithashtu nga një janari 2017 në Kroaci për qytetarët që blejnë rrymë është zvogëluar TVSH-ja për shpërndarjen e rrymës prej 25 në 13 për qind.

ÇMIMI NUK KORRESPONDON ME STANDARDIN E JETËS

Në fund vlen të theksohet , se përkundër faktit se çmimet e energjisë elektrike në Maqedoni janë më të ulëta se ato në shtetet e Bashkimit Evropian, megjithatë kur krahasojmë fuqinë blerëse apo pagat tona prej 300 euro në raport me 3000 euro në Danimarkë, del se llogaritë e energjisë elektrike për një amvisëri tek ne janë gati të njejta si në shtetet perëndimore.

Kjo mbështetet edhe nga fakti se sipas të dhënave të Eurostat për vitin 2016, një kilovat orë në Maqedoni ka kushtuar 0.083 euro, ndërsa nga ana tjetër në Danimarkë, një kilovat orë e energjisë elektrike kushton 0.308 euro, tregojnë të dhënat e Zyrës evropiane të Statistikës.

Sipas Eurostat , çmime më të lira se Maqedonia të rrymës, ka vetëm Kosova me 0.059, Serbia me 0.065 euro dhe Ukraina me 0.032 euro për kilovat rrymë. Gjithashtu, duhet përmendur se këto shtete akoma nuk kanë kaluar procesin e privatizimit të së paku një pjesë të sistemit elektroenergjetik.

Në ndërkohë , Eurostat zbardh se çmime të ngjashme të rrymës si në Maqedoni, paguajnë Shqipëria dhe Bosnje e Hercegovina me nga 0.084 euro për një kilovat orë. Çmime jo të lira paguajnë edhe Mal i zi me 0.097 dhe Moldova me 0.092 euro për një kilovat orë. Nga ana tjetër Danimarka me 0.308 dhe Gjermania me 0.298 euro për kilovat orë paguajnë rrymën më shtrenjtë në Evropë. Çmimi mesatar i një kilovat ore rrymë në 28 shtetet e BE-së në vitin 2016 ishte 0.205 euro .

Kërkohet kërcënuesi i gjykatëses Kacarska

Shkup, 8 qershor - Sigurim policor për gjykatësen Dobrila Kacarska është miratuar tashmë dy javë me kërkesë të Gjykatës Penale, konfirmoi dje në konferencë për media ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. "Kemi obligim për të gjithë bartësit e funksioneve publike për të cilët do të ketë kërkesë apo ekziston rrezik sigurie të sigurojmë mbrojtje të integritetit dhe të personit. Në këtë rast në bazë të kërkesës nga Gjykata, ndërsa pas vlerësimit të bërë në shërbim, i është ndarë sigurim fizik gjykatëses Dobrilla Kacarska", deklaroi Spasovski duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve për vendimin e sigurimit të gjykatëses Kacarska. Policia, siç theksoi, punon në procedurën për zbulim kush dhe pse i bënë kërcënimet, por për këtë do të informojnë kur do të ketë më shumë informacione. Kacarska e udhëheq lëndën "Tenk" të Prokurorisë Publike Speciale në të cilën e shqiptoi masën dënim me burg të ish-kryeministrit Nikolla Gruveski dhe ish-ndihmësministrit të Punëve të Brendshme Gjoko Popovski. Në këtë rast akuzohet ish-ministrja e Punëve të Brendshme Gordana Jankullovska, për të cilën për shkak shtatzënisë së rrezikshme u veçua procedura.

CILËSI E TË USHQYERIT TË FËMIJËVE NË KOPSHTE

A MUND TË KETË SANKSIONE PËR KEQUSHQYERJEN?

Prindërit ankohen se nuk kanë kohë të merren me fëmijët, ndërkohë që në kopshtet nuk ka ushqim të llojllojshëm dhe cilësor, ndërkohë që të sigurohet ushqim cilësor dhe i shëndetshëm, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka menduar të aplikojë sanksione dhe mbikëqyrje të cilësisë së ushqimit në shkolla

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 8 qershor - Cilësia dhe mënyra e të ushqyerit janë faktorë të rëndësishëm në jetën e njeriut. Nga ajo çka mund të vërehet, njeriu modern i është ekspozuar praktikave aspak të përshtatshme të të ushqyerit dhe për pasojë sot në botë po shtohet popullata që ka probleme me mbipeshën.

Në Maqedoni ka kohë që hetohet problemi i kequshqimit të fëmijëve të moshave 3-12 vjeçare. Ushqyerja e dobët ndikon jo vetëm në zhvillimin fizik, por edhe në nxënien e njohurive, shprehet përfaqësuesi i UNICEF-it, Benjamin Perks, dhe shton se duhet të promovohet ushqimi cilësor në shkolla si një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës, që do ta ndalonte ciklin e brezave të kequshqyer.

Prindërit ankohen se nuk kanë kohë të merren me fëmijët, ndërkohë që në kopshtet nuk ka ushqim të llojllojshëm dhe cilësor. Të gjitha këto kanë ndikuar që fëmijët të mos kenë zhvillim normal, por përkundrazi mbipesha po bëhet pjesë e rritës së tyre, që në instancë të fundit ka pasoja për shëndetin.

Mjekët thonë se fëmijët duhet të inkurajohen për konsumimin e sasive të mjaftueshme të ushqimeve të pasura me vitamina, kripërave minerale, pa lënë pas dore asnjëherë frutat dhe perimet. Duhet të angazhohen prindërit dhe edukatoret që të shmangin gabimet më të shpeshta në ushqyerje të fëmijëve. Fëmijët duhet të mësohen të hanë në ushqim që nuk shkakton pasoja në zhvillimin e tyre.

"Mbesa ime është 6 vjeçare dhe shkon në kopsht, atje pjesërisht ushqehen shëndetshëm. Gjithmonë konsumojnë produkte me sheqer, dhe ajo e ka mendjen te ëmbëlsira. Sot fëmijët janë të padëgjueshëm, por edhe prindërit janë shumë të angazhuar me punë dhe lënë pas dore fëmijët. Po ashtu, mungesa e shprehisë së ngrënies në kohë, sipas një orari të caktuar si në shtëpi dhe në kopsht, është pakujdesi ndaj fëmijës", thotë gjyshja Luljeta, për gazetën "Koha".

Me mungesën e frutave dhe perimeve të freskëta dhe përbërësit në ushqime si kalcium, hekur dhe zink, si dhe produkte me shumë sheqer dhe kripë, përballen fëmijët në Maqedoni. Ky konstatim ka dalë nga një hulumtim që është bërë kohëve të fundit në Shkup, ku detektohen problematika të ndryshme të të ushqyerit që janë edhe sfidë globale. Pediatri Armir Haxhirexha thotë për gazetën tonë se në ciklin e jetës së fëmijëve, ushqimi cilësor luan rol të veçantë është shumë e rëndësishme që dieta që ata e marrin në shkollë, të jetë e larmishme dhe e pasur me vlera ushqyese.

Ndërkohë po përgatiten edhe ndryshimet legjislative që sanksionojnë moszbatuesit e rregullores për standardet e të ushqyerit në shkollat fillore. Por Mila Carovska, ministre e Punës dhe Politikës Sociale është e mendimit se Maqedonia si shtet është i varfër dhe një pjesë e familjeve nuk mund të ofrojnë ushqim të balancuar për fëmijët e tyre. Për këtë arsye, sipas saj, sistemi dhe shoqëria përmes kopshteve dhe shkollave duhet të plotësojë të paktën cilësinë minimale të ushqyerit, që fëmijët e konsumojnë për çdo ditë dhe MPPS po bën përpjekje për të rritur përfshirjen e fëmijëve në kopshte, dhe për të patur një vakt të duhur.

Që të sigurohet ushqim cilësor dhe të shëndetshëm, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka menduar të aplikojë sanksione dhe mbikëqyrje të cilësisë së ushqimit në shkolla. Ushqyerja e dobët ndikon jo vetëm në zhvillimin fizik, por edhe në nxënien e njohurive, shprehet përfaqësuesi i UNICEF-it, Benjamin Perks, dhe shton se duhet të promovohen ushqimi cilësor në shkolla ku edhe mund të çojë në një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës dhe për të ndaluar ciklin e brezave të të në ushqyerit keq.

KRYEMINISTRI ZAEV VIZITON POROJIN

BANORËT KËRKOJNË VEPRA E JO FJALË

Përderisa autoritet lokale dhe ato qendrore të rregullojnë dokumentacionin banorët e këtij fshati jetojnë në ankth dhe frikë për vërshime të reja

Tetovë, 8 qershor - Edhe një vit pas vërshimeve në fshatin Poroj gjendja nuk është normalizuar në tërësi, shtrati i lumit nuk është pastruar në tërësi, ura kryesore në rrugën Tetovë-Jazhincë vazhdon që edhe më tutje të jetë e dëmtuar dhe e rrezikshme për trafikun, pushteti lokal dhe ai qendror ende nuk kanë filluar të realizojnë premtimet që dhanë përpara banorëve të këtij vendbanimi siç është pastrimi në tërësi i shtratit të lumit, rregullimi dhe sigurimi i urës kryesore dhe urave të tjera brenda fshatit, si dhe vendosja, gjegjësisht ndërtimi i kaskadave në rrjedhën e këtij lumit me qëllim që të mos përsëritet çdo vit e njëjta histori me vërshimet, dhe të mos ndodh ndonjë tragjedi e madhe. Kryeministri Zoran Zaev në lidhje me premtimet e dhëna përpara banorëve të Porojit tha se për vendosjen e kaskadave në rrjedhën e lumit të Porojit që nënkupton një zgjidhje afatgjate është rregulluar dokumentacioni i nevojshëm për aplikimi me të cilin është aplikuar, është kryer studimi i fizibilitetit dhe ky projekt do të realizohet me mjete buxhetore dhe mjete nga donatorët.

"Tanimë kemi aplikuar,është rregulluar dokumentoacioni i nevojshëm, studimi fizibilitetit i realizuar në bashkëpunim me ambasadën e Zvicrës tashmë është kryer në mënyrë që atje të sigurohet një zgjidhje e përhershme siç është rregullimi i lumit në Poroj me kaskada të cilët do të duhet që të bëhen për të mbrojtur Porojin. E dini që atëherë kur ndodhën vërshimet, ne kemi intervenuar menjëherë me para të buxhetit për të pastruar shtratin e lumit nga materiali që kishte sjellë lumi nga vërshimet, por procedurat e aplikimit në projektet kryesore janë procedura që marrin më shumë kohë më shumë muaj ,vite, megjithatë unë besoj se një ndër prioritetet që ne kemi në fushën e mbrojtjes nga këto katastrofat natyrore që ndodhën në Maqedoni , ndërsa pamë që më intensive janë ne rajonin e Tetovës prandaj për ndërtimin realizimin e projektit në Poroj do të gjejmë edhe mjete buxhetore edhe mjete nga donatorët", tha Zaev.

Ndërkohë që Teuta Arifi, kryetare e komunës së Tetovës, sërish ka theksuar se është duke u punuar në të gjithë ato premtime që janë dhënë."Ne në mbledhjen e qeverisë që ka qenë për projekte nga fonde të mbetura të operatorit tanë, është një thirrje që ka bërë qeveria e afatizuar deri më 31 maj. Në mesin e projekteve me të cilat është paraqitur komuna e Tetovës në këtë thirrje është edhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit të Porojit , kështu që ta përkrahim këtë mendoj që do të ishte një realizim premtimi", tha Arifi. Sipas saj, realizimi i projekteve tjera shihet tek financimi nga na e UNDP-së.

"Ajo që mbetet shumë e rëndësishme është projektimi i cili është marrë përsipër me ndihmën e UNDP-së për sa i përket rregullimit dhe parandalimit të rrjedhjeve intensive të lumit, me disa kaskada të cilat do të zvogëlonin rrezikun për pjesën e poshtme, kjo domethënë është një obligim që e kanë marrë përsipër edhe partnerët tanë siç e dini ne kemi qenë në teren së bashku me zonjën drejtore ambasadore të UNDP-së dhe mendoj që kjo po ashtu do të jetë një çështje që do të zhvillohet në të ardhmen , kurse rrjeti shpërndarës i ujit është me leje të plotfuqishme me projekt valid dhe i njëjti mendoj se do të ishte mirë nëse përkrahet nga komisioni që ka formuar qeveria", deklaroi Arifi. Përderisa autoritet lokale dhe ato qendrore të rregullojnë dokumentacionin banorët e këtij fshati jetojnë në ankth dhe frikë për vërshime të reja. *(U.H)*

Shehidët e ditëve tona

Nga
Daut DAUTI

Një ditë ramazani, këtyre ditëve, rastisëm të bëjmë iftar në një restorant dhe pasi thirri ezani dhe çelëm iftar, nga altoparlanti dëgjonim një ilahi e cila fliste për shehidët! Për ata që me flijesën e tyre "për shehadet", kanë rënë nëpër fushëbeteja. Kënga ishte në gjuhën shqipe, se ndryshe nuk do ta kuptoja porosinë që më shtyri të mendoj në një kontekst të gjerë dhe të ngushtë të fjalës. Lexuesit dhe mund të tmerrohen nga tmerrimi im që në atë moment ndjeva duke kujtuar shumë "shehidë" nga mesi ynë të rënë në do vatra të largëta konfliktesh ku kishin shkuar të luftojnë.

Rëndom nuk e kam qejf të përfshihem në debate jashtë fushës sime profesionale, prandaj dhe kjo qasje le të jetë pak një e drejtë qytetare për t'i shtruar të paktën në mënyrë laik disa pyetje e dilema në adresë të atyre që atyre që janë të thirrur t'u japin përgjigje. Derisa shkonte në altoparlant kjo ilahi, në restorant ishte një imam i njohur, e ndoshta kishte dhe të tjerë që s'i njihja, e që duhej të ishin më të mbathur në pikëpamje të teorisë së islamit, por, kuptohet, në një iftar dhe nuk ka vend për nasihate, për t'i zbërthyer këtë dhe ndonjë temë tjetër, përveçse një duaje të iftarit. Por, gjithsesi, pasi ta ketë dëgjuar këtë ilahi hoxha i nderuar, ka për obligim që në xhaminë e tij t'i rreket çështjes dhe t'ua zbërthejë xhematit të tij në ndonjërën nga ligjëratat e Ramazanit se si dhe kur ndokush mund të fitojë epitetin dhe statusin e lëvduar të shehidit në ditët tona, e sidomos, të sqarojë sa këtë a e meritojnë ata besimtarë nga mjedisi ynë, që ua kanë mësy do luftërave në hapësira të largëta gjeografike...

Kam dëgjuar një rrëfim për një shkupjan i cili paska shkuar në një nga këto lufta për të mbrojtur myslimanët e rrezikuar dhe në atë rrëmujë të madhe në Siri, dhe i cili kishte ardhur në pozitë që të vrajë myslimanë të tjerë, ndër ta dhe një mik të vetin, i cili, në rrethana të çuditshme, kishte qenë në një grup tjetër myslimanësh. Kur kishte kuptuar se kë kishte vrarë, kishte ngushëlluar veten me fjalët "e bëra shehid"! Pyetja që ia ka shtruar vetvetes gjithsesi duhet ta ketë tronditur këtë "kandidatin" tjetër për shehid, i cili për një moment siguristë është ndalur të mendojë, ose e ka çarë kokën gjatë gjithë kohës kur ka qenë në atë rrëmujë luftërash, si është e mundur të luftojë një mysliman kundër myslimanit tjetër, dhe të fitojë statusin e shehidit? Logjika thotë se nëse njëri është shehid, tjetri duhet të jetë katil! Hoxhallarët tanë duhet të dalin nga klisheja se myslimani gjithnjë bën luftë të drejtë, sepse kur do ta hyjmë për t'i analizuar kontekstet e çdo konflikti, mund të hasim në pak gjëra me motiv fetar! Pra, lypset jo vetëm dije që i shpjegon termet(shehidët përshembull) por dhe kontekstualizim në situatë konkrete të konflikteve ku në të dy anët janë përfshirë myslimanë.

Konfuzioni nuk është doktrinar, sa është pragmatik në planin e manipulimit me ndjenjat fetare. Hoxhallarët tanë duhet të dalin nga klisheja se myslimani gjithnjë bën luftë të drejtë, sepse kur do ta hyjmë për t'i analizuar kontekstet e çdo konflikti, mund të hasim në pak gjëra me motiv fetar! Pra, lypset jo vetëm dije që i shpjegon termet (shehidët, për shembull), por dhe kontekstualizim në situatë konkrete të konflikteve ku në të dy anët janë përfshirë myslimanë. Logjika thotë se nëse njëri është shehid, tjetri duhet të jetë katil!

Ka nevojë për shpjegime sepse në këtë mënyrë do t'ua lehtësojnë "zgjedhjen" që bëjnë për të shkuar atyre naivëve të devotshëm se cilës palë ndërluftuese myslimane duhet t'u bashkëngjiten që të bëhen shehidë nëse bien për kauzën e tyre! Edhe pse për fat dukuria për të cilën po flas ka filluar të bie në pikëpamje masiviteti, kjo ilahi na kujtoi praktikisht dhjetëra e qindra "kandidatë" për shehidë që nga këto hapësira ballkanike u janë bashkangjitur viteve të fundit lëvizjeve që aspektin e mbrojtjes së islamit e kanë pasur në thelbin e ideologjisë së tyre. Saktësisht nuk dihet, por mund të supozohet se përveç se në Isis, Al Nusra, ndoshta ka pasur edhe luftëtarë në mesin e talebanëve ose ndonjë lëvizje tjetër. Por, si janë gjetur ata në ato situata kur për së afërmi kanë kuptuar se lufta e tyre nuk ka qenë si në film "myslimanë kundër dushmanëve" por "myslimanë kundër myslimanëve", madje shpesh të doktrinave të njëjta ose të ngjashme, tek të cilët dallimi ka qenë për shkak të agjendave që dalin jashtë suazave fetare dhe bëhen kauza politike.

Konfuzioni nuk është doktrinar, sa është pragmatik në planin e manipulimit me ndjenjat fetare. Ai konfuzion këtu te ne është edhe më i madh, përderisa në vetë burimin(atje ku është djepi i myslimanizmit), ku dijetarët islamë duhet t'i shpjegonin më mirë gjerat, sh-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premte 8 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

pallen martirë edhe ata të cilëve dikush ua shpërlan trurin dhe me eksploziv i fusin në tregje, autobusë, shkolla madje edhe objekte fetare, që të vrasin njerëz të pafajshëm duke u vetëvrarë! Vetëvrasja është njëra nga gjërat më të ndaluara në islam, apo jo?!

Me këtë rast dua të përkujtoj një rast që ka ndodhur në një lokal nate në Egjipt kur nga zjarri kanë humbur jetën shumë persona. Ndonëse rasti tragjik, në një shou satirik është improvizuar një intervistë e trilluar me pronarin, i cili, i kishte quajtur "martirë" ata që e kishin humbur jetën dhe që sipas tij, me këtë do të hyjnë në xhenet. I pyetur nga udhëheqësi i emisionit se si ka ardhur në përfundim të tillë, ai është përgjigjur "A nuk janë egjiptianë ata? Kur egjiptianët vdesin, a nuk i quajmë martirë? Pse të mos i quajmë edhe këtë martirë?". Porosia e kësaj është karrikimi me përdorimin e fjalës martir për të gjithë ata që vdesin për shtetin e vet, pa hyrë në detaje se me çfarë qëllimi shteti i vet e ka dërguar në atë operacion ushtarak.

Problemi qëndron jo vetëm në thelbin e fjalës, por në përzierjen e kauzave fetare e politike, kur shpesh nuk mund të ketë autoritet relevant që do të ndante shapin prej sheqerit, që do të shpjegonte kur bëhet fjalë për një kauzë të drejtë politike ose fetare(në ditë të sodit praktikisht kauza e dytë është nën hijen e së parës!). Një mysliman ballkanas vërtet mund të jetë i brengosur për fatin e "vëllezërve myslimanë" në shumë vende të botës, por me çfarë mendsh futet në atë vorbull ku s'dihet kush me kë dhe përse lufton?! Aq më tepër të bie shehid duke luftuar pranë disa "vëllezërve myslimanë" e kundër "vëllezërve" tjerë myslimanë.(Dorën në zemër, nga këto hapësira kanë pasur pjesëmarrje në shenjë solidariteti edhe në lëvizje tjera për motive ideologjike...). Shtetet kanë qëllimet e tyre, si bie fjala Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe me intervenimin e tyre në Jemen, kundër rebeleve Huthi, ku marrin pjesë edhe disa shtete tjera, kur humb jetën ndonjë pilot, mediat e këtyre vendeve i quajnë "shehidë". Jemeni është vend me shumicë sunite, ku jetojnë edhe shiitët zejdi, që janë shumë të afërt me sunitët. Në Siri lufta popullore nisi kundër regjimit autoritar të Asadit(pra, për motive politike), e u bë pastaj lesh e li, ku qeni të zonë nuk e njihte. Pak kush këtu ndër ne e dinë se para se të ndodhte intervenimi amerikan ndaj regjimit të Mulla Omarit, në Afganistan kishte një rivalitet dhe konflikt shumëvjeçar midis talebanëve dhe muxhahedinëve! Pra, të dy palët të deklaruar si myslimanë të pastër. Një ballkanas në cilën anë do të rreshtohej midis dy grupacioneve myslimane të një populli të largët? Në Irak, pas intervenimit ndaj regjimit të Sadam Hyseinit, më shumë janë vrarë myslimanë mes veti se nga intervenimi i jashtëm. Pra, që të pretendosh të futesh në përplasje lëvizjesh të ndryshme, të cilat shpesh fenë e kanë paravan për qëllimet e tyre politike, kërkon një kthjelltësi e jo besim i verbër e naiv se do ta fitosh xhenetin nëse i bashkëngjitësh ndonjë lëvizjeje me atribute fetare.

Duhet të përkujtojmë se që nga shekulli i 9-të myslimanët nuk kanë jetuar në një shtet të përbashkët , dhe vazhdimisht ka pasur shumë konflikte midis popujve a mbretërive (shteteve) myslimane dhe a thua ato kanë qenë për shkaqe fetare, apo për supremacion politik? Sa mund të jenë shehidë ata që shkojnë në luftërat myslimane-myslimane, madje kur të shpeshtën dhe nuk kanë dallime doktrinare? Një hadith thotë se martir është një mysliman që vdes duke mbrojtur pronën e tij, prej kësaj mund të shtojmë edhe duke mbrojtur edhe pragun e shtëpisë, familjen ose atdheun (nga Perandoria Osmane bie fjala ka mbetur fjala "pa vatan nuk ka iman"...), por ndoshta thelbi qëndron në një hadith që duhet më shpesh ta citojnë imamët tanë që thotë se kur dy myslimanë ndeshen me njëri tjetrin me shpata, atëherë si vrasësi, si i vrari do të gjenden në ferr. (Në raste kur dy myslimanë duan ta vrasin njëri tjetrin, të dytë shkojnë në ferr. Në rast kur njëri është agresor, atëherë tjetri është shehid").

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Shëndetësia shëndetligë!

Nga
Dr. Arben TARAVARI

Po, kemi shëndetësisë sëmurë. E kam fjalën sigurisht për institucionin që e drejton. Jo se e kemi pasur ndonjëherë me shëndet të plotë por të paktën kishte përmirësime.

Kam shumë vite që punoj si mjek, kjo ka qenë edhe mënyra ime e jetesës me thënë të drejtën, kaloja shumë më shumë orë në klinikë se sa në shtëpi. Jam i dedikuar nga profesionit tim si shumica e kolegëve të mi. Mjekët kalojnë vite të gjata studimi, gjatë kësaj kohe ata nisin e kalisin ndërgjegjen e tyre, fillojnë të mësohen me praninë e dhimbjes, dhe si të thuash në një farë sensi janë luftëtarët frontalë të vuajtjeve dhe vdekjeve.

Por mjekët janë luftëtarë të paarmatosur këtu tek ne. Nëse do të vazhdoja të përdorja metaforën e luftëtarëve, atëherë ne jemi luftëtarë të lënë gjithë kohës në fushëbetejë por nuk kujdesen që të kemi trajtimin e duhur... Mjekët e papaguar vjen një pikë dhe shndërrohen në mjekë të dorëzuar. Kush e ka në dorë trajtimin financiar të mjekëve? Qeveria, në mënyrë specifike Ministria e Shëndetësisë.

Kjo Ministri u drejtua nga partia e Aleancës dhe mua më caktuan të punoj si ministër. Krijuam një ekip të mirë, kryesisht të përbërë nga mjek të suksesshëm në terren, këtë e theksoj pasi duke ardhur nga baza, nga puna në spital, je shumë më i qartë për mungesat titanike të spitaleve tona, duke filluar si për ironi nga mungesa e vet spitaleve. Gjatë kohës që nisëm punën krijuam një strategji të shëronim sistemin e Shëndetësisë, kështu do të krijonim më komoditet tek personeli mjekësor e si derivat do të kishim pacientë më të shëndoshë, që është edhe qëllimi i mjekësisë si shkencë.

Megjithëse të rinj si punonjës në Ministri, ishim në kohën e qeverisë Zaev që sapo ishte zyrtarizuar si e tillë, ne patëm sukses. Mua personalisht nuk më pëlqen të flas aq shumë për sukseset se sa për përpjekjet por si rrallë herë do të flas për këtë gjë pasi jam shqetësuar shumë nga rezultatet e Ministrisë së Shëndetësisë që kur e mori në duar LSDM-ja.

Kështu kur Shëndetësia drejtohej nga partia jonë, ne arritëm që të ishim ekipi më i besueshëm në popull. Kur qendra e sondazheve IRI, zhvilloi një të tillë për 6 mujorin e parë të qeverisë Zaev, Ministria e Shëndetësisë rezultoi të ishte më e besuara nga njerëzit. Në fakt ne ishim të parët në këtë listë duke kaluar dhe vet kryeministrin. Ky natyrisht që ishte sukses i jashtëzakonshëm për ne si parti, për ekipin e mjekëve, juristëve, ekonomistëve që drejtoja, ne po kthenim shpresën tek bluzat e bardha, e cila me thënë të drejtën është kryesorja në marrëdhënien e komplikuar të sëmundjes me individin.

Gjithsesi, ky nuk është ndonjë përvjetor i punës tonë në Ministri, pasi unë e lashë atë vend pune e tash punoj si Kryetar Komune në Gostivar (Eja në Gostivar), partia e Aleancës ku bëj pjesë nuk ishte dakord me rikthimin e politikave të vjetra dhe u kthye në partinë e parë që do braktiste qeverinë, ndaj e theksoj që pas largimit tonë ne nuk kemi ndonjë lidhje në sukseset apo mos sukseset e qeverisë, por e përmenda IRI-in dhe faktin që Ministria e Shëndetësisë që drejtoja doli e para në listën e besueshmërisë, pasi tani për fat të keq, nga një sondazh të zhvilluar nga televizioni Telma, një nga ministritë që populli beson më pak është pikërisht e shkreta ministri e Shëndetësisë.

Në vitin 2017 patëm fatin e madh që të kishim eksodin më të vogël të mjekëve krahasuar me vitet e tjera. Ne punonim që t'i mbanim mjekët këtu ndaj ata nisën të rrinë, pasi u largua ASH-ja nga posti natyrisht nuk u largova nga bindja që çdo gjë do shkonte mirë në këtë institucion, por u shqetësova kur dëgjova që në periudhën që ministria udhëhiqet nga një ekip i ndërtuar nga LSDM-ja, brenda 4 muajve kanë 110 mjekë... humbje e madhe për vendin! Tani këtë analizë nuk e bëj se dua të fitoj pikë politike, jam shumë mjek për të bërë politikë me shëndetin e njerëzve,dhe pikërisht se jam i tillë jam mësuar që për të kuruar një sëmundje duhet gjetur shkaku!

Shëndetësia në Maqedoni ka anemi

Nuk është faji i tij që nuk është i aftë në këtë punë, është faji i atyre që, edhe pse po shohin rënien e menjëhershme të nivelit të shëndetësisë, vazhdojnë dhe e mbajnë ministër. Përsëris që është një mjek brilant i dënuar të vuajë dështimin si ministër! Kjo Qeveri ka falimentuar në një sektor që e kam shumë për zemër, e për më shumë që është jetike për vendin. Ndaj, mbani mjekët këtu, ose ndryshe do vijnë në fuqi kurimet popullore!

mjekësh e Zot na ruaj mund të kaloj në leukemi fatale që s'do ngelet këmbë mjeku! Ku është problemi?! Sigurisht një pjesë e mirë do thonë "ministri Filipçe". Nuk është se dua ta zhvesh nga përgjegjësia, sigurisht dhe ai ka të tijat, e ndoshta po, më të mëdhatë, por sigurisht dhe ai që e ka vendosur si të tillë. Venko Filipçe është një doktor i talentuar, është një nga neurokirurgët më të mirë që kemi, është një shok i mirë i imi, por mos e dënoni duke e lënë ministër.

Nuk është faji i tij që nuk është i aftë në këtë punë, është faji i atyre që, edhe pse po shohin rënien e menjëhershme të nivelit të shëndetësisë, vazhdojnë dhe e mbajnë ministër. Përsëris që është një mjek brilant i dënuar të vuajë dështimin si ministër! Kjo Qeveri ka falimentuar në një sektor që e kam shumë për zemër, e për më shumë që është jetike për vendin. Ndaj, mbani mjekët këtu, ose ndryshe do vijnë në fuqi kurimet popullore!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

KOHA e lirë 96

shtojcë enigmatike e fundjavës

FJALËKRYQI KLASIK



HORIZONTALISHT

3. Qeni i njohur i filmave, Tin Tin
5. Secila nga dy pjesët kockore të zgjatura në ballin e kafshëve
7. Bimë barishtore njëvjeçare
9. Shtet në Azi
10. Binjakë
12. Autori ynë, Gashi (1939-1995)
13. Kruese e metaltë për kashaisjen e kafshëve
15. Aftësia e jashtëzakonshme për të bërë çudira
16. Gotë çaji, bardak
18. Aktori ynë, Dritëro
20. Pistë italiane e Formula 1
23. Banjë mjekuese
24. Çokollatë e njohur me kikirik
26. Numra me të cilin identifikohen produktet
28. Bir i birit
29. Shqiponja
30. United States of Amerika
31. Banor i një qyteti kosovar
33. Studiuesit e amerikanistikës
41. Dredhacak
42. Pushimore e njohur në Sarandë
43. Kampioni
44. Myhyri
47. Lloj veture e Krajslerit
48. Djall, shejtan
49. Prijësi i emirateve

VERTIKALISHT

1. Që i përket hipizmit
2. Film i Isa Qoses
3. Skllav
4. Një prind
5. Kullosa
6. Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
8. Bie (bora apo shiu)
9. Normë, rregull
11. Ndërtesa e shenjtë e Mekës
12. Shtet në Afrikë
14. Dy, romak
15. Kufomë njeriu e balsamosur
17. Rozafa te "O sa mirë" (në foto)
18. Hajdut, kriminel
19. Autori ynë Krasniqi (1920-2015)
21. Pjesë e syrit, bebëz
22. Opera e shkurtë
23. Molibdeni
24. Zoti i krokodilëve te egjiptasit
25. Inicialet e aktorit Pitarka
27. Vendi kufitar turqi-Bullgari
30. Gjëja e rrallë, unike
33. Toka e punuar
34. Futbollisti argjentinas, Lionel
35. I vogli i dhisë
36. Radiumi
37. Inicialet e humoristit Sallaku
38. Mauzoleumi indian, Mahall
39. Revolucionari Duraku
40. Lloj
45. Dëm i madh, shkatërrim i madh
46. numri neutral

Kakuro

e lehtë



mesatare



e vështirë



KOHA e lirë
për më të rinjtë

FSHEHËSIRA

Zbuloni figurat e fshehura!

10 dallime

Cilët janë ato?



FIGERMA (lexoni me objekte)

Qytetet

Figurat gjeometrike përfaqësojnë shkronja. Zëvendësoni ato dhe do të gjeni pesë qytete të Maqedonisë!

Figurat paraqesin shkronja, varësisht nga forma e tyre. P.sh. te rrathët do t'i shënoni zanoret.

- ○ a, e, o, u, y
- ○ ë, i
- □ c, ç, m, n, r, s, v, x, z
- □□ rr
- □ b, d, f, h, k, l, t
- □□ dh, ll, sh, th, xh, zh
- □□ gj, nj
- □ g, j, p, q

Ndihmë: *Janë përdorur 15 shkronja të ndryshme, prej të cilëve 5 zanore.*

DEKODIMI

Fjala e kërkuar fillon nga katrori i vogël dhe përfundon te rrethi.

Duhet të zgjidhni njërën nga katër shkronjat në secilën fushë dhe të vazhdoni në fushën tjetër.

Në fund, lexuar me radhë fitohet zgjidhja e kërkuar (një kafshë).



Zgjidhja:						

SHUMA

Çdonjëës shenjë i korrespondon nga një numër.

Zëvendësoni ato që t'i fitoni shumat e dhëna (djathtas dhe poshtë tabelës).

Sa është shuma e kolonës së dytë?

@	&	&	$	23
@	#	#	€	18
@	&	€	$	24
#	#	€	&	15
24	?	17	25	

Mini KENKEN

Në kutizat e dhëna shënohen vetëm numrat 1, 2 dhe 3. Ashtu si te sudoku edhe këtu në çdo rresht dhe kolonë nuk guxon të ketë numra të njëjtë. Numrat në skajet e sipërme të katrorëve e tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë tyre, operacionin matematikor që duhet ta përdorni për të arritur deri te rezultati.

3 ×		1 -
1 -	8 +	

© 2014 KrazyDad.com

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "*është më i madh se*".



KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.



ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



MOSBARAZIMI

Plotësoni tabelën duke u bazuar në operacionin e mosbarazimit. Përdoren numrat prej 1 deri 5.



NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



ARITMOGRIFI - fjala e urtë

Përgjigjet i shënoni në rrjetin me numra (majtas), pastaj, sipas rregullit ***"numri i njëjtë - shkronja e njëjtë"***, shkronjat e fituara bartni në tabelë (poshtë)! Do të fitoni një fjalë të urtë.

1	2	3	4	5		
6	7	8	9	10	11	
12	13	14	15			
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	
29	30	31	32	33		

HUMNERË
SABAH
KAFSHË SHTËPIAKE
LUTJE ZYRTARE ME SHKRIM
JON ME NGARKESË POZITIVE
REGJISORI AMERIKAN, UELLS

6	27	11	3	23	17	30	12	32

9	26	14	2	22	18	15	8

33	5	19	13	31	29	4	20	28	10	16	24	1	25	7	21

Përgjigjet përbëhen nga këto rrokje:

GJES, I, KA, KAT, KE, KËR, LË, LLË, MËN, ON, OR, SË, SON, SHPE.

NUMËRKRYQI



Horizontalisht

1. Viti i lindjes së Aristotelit
3. ABC-ja e shifrave
5. Viti i lindjes së Mohamedit
6. Identike e ***1 vertik.***
8. Shifra të njëjta
10. Levi's
12. CXXVI
14. Voltazha kryesore e elektricitetit
15. $1^1+3^2+5^3$
16. Peugeot

Vertikalisht:

1. Sanduiç i numrave tek me plotpjesëtuesin e tyre
2. Viti i vdekjes së Atilës
3. Dalmatët
4. Fillo!
7. Viti i lindjes së Avicenës
9. Numri i policisë
10. DLX
11. Kubi i 5-shes
12. Palindrom i ***10 horiz.***
13. Beteja e Bedrit

MOZAIKU
vepër letrare

Pasi t'ua gjeni vendet autorëve shqiptarë dhe botërorë (emri apo mbiemri) në fjalëkryq, në fushat e rrethuara do të fitoni veprën e njohur të Jeronim de Radës.

4 shkronja

ADEM, DEFO, DYMA, DHORI, GËTE, GLEN, LUAN, MUÇO, NUHI, ZIBA

5 shkronja

ADEMI, AHMET, IMAMI, NIKOL, TAHIR, VEDAT

6 shkronja

ANANDI, ANATOL, DIKËNS, DIONIS, ISLAMI, LAKRUA, MARVEL, MARVIN, MASIMO, MEKULI, STAVRI

7 shkronja

ARONSON, ERIKSON, MUSTAFA.

Fjala e urtë:

1 2 3 4 5 6 7
8 9 10 11 12 13 14 15



Sudoku

i lehtë

9	1				8		7	4
8		4			7	9		2
			6		3	4		
		6		2		3		
		7	5		4			
7		2	4			5		6
5	4		8				3	9

mesatar

			7	6	3			2
		7		9			6	8
				1		3	7	
4					7			1
2	5	3				7	9	4
1			2					6
	2	4		7				
8	6			2		4		
7			6	5	4			

i vështirë

9			8				3	7
			3					1
	1		7				9	5
		4		8				
6					2	5		
		2					7	
	9			1			2	3
8	3				9			

SKANDI I KOMBINUAR

Shkronjat e pjesës ***së hijezuar*** të fjalëkryqit bartni në tabelë. Me ato shkronja do t'i fitoni zgjidhjet e ***anagramit*** dhe ***rebusit***.

1	2	3	4	5	6	7	8
9	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**	**16**



Anagram

9	6	7	8	1	15	2	10	11	3	12	16	13	14	4	5

Rebusi

9	1	5	4	13	7	12	3	11	14	10	8	16	15	6	2

MENSUR MAMUTI	SHPUZORET	AKTPRJA JONË, ALIKAJ	AUTORI YNË, GASHI	FIZIOLOGJIA PATOLOGJIKE	REGJISORI ITALIAN, SKOLA	ISH VRAPUESI KENIAN, HENRI	FLORI	METRI	GAZETARI YNË, AZEMI	MARR RRUGË	NISMA / THAJ	F
FORCA JETËSORE, GJALLERIA												
PILOT								PRODUKT I DRITHIT / MASHKULL I MACES				
LETËR E TRASHË							KOLLOMBOÇI / PËRFUNDIM NË SHAH					
ENERGJIA		BUKË QË U JEPEJ USHTARËVE / TË VËRTETAT (SH. PASHQ.)				1	2				METRI / AKTORJA UEDEZE, EKLAND	
KUPË, MEDALJE					3	■	4	5	SIPËR, PËRMBI / FSHIHET PRAPA HORIZONTIT (PËR DIELLIN)			
UNIONI EVROPIAN			ITALIA / GROPA PËR TË MBLEDHUR UJIN E SHIUT	6	■	7	8	1	9	REOMIRI / ZGJON PËRSËRI		DOKRRA, GJEPURA (SH.)
ÇESHTJET			10	11	4	8	■	12	3	13		
QYTET SHQIPTAR / MËNYRË E TË SHKRUARIT			14	4	7	4	15	■	13	6		
S				■	12	13	4	14	16		KALIUMI / Ë.R.	
KOHA E LIRË	LETRA BIXHOZI (PËR PARASHIKIM) / AKTORJA AMERIKANE, MERI				1	8	■	3				
AFRIM EMINI			ILINIUMI / SËMUNDJE E MENJËHERSHME DHE E RËNDË			■	4					
SJELL NË GJENDJE NORMALE											GJERMANIA / MJERIM I MADH, FATKEQËSI E MADHE	
ARMË GJAHU ME NJË TYTE					FUTBOLLISTI BOSHNJAK, XHEKO / PARAFJALË GJERMANE					POSEDON / SELENI		
OKSIGJENI		STUHI E MADHE ME ERË DHE ME SHI / URANIUMI							KËTË DITË / 1000 ROMAK			
PUNË E PËRDITSHME							KAFSHA MË E THJESHTË NJËQELIZORE					



Të enjten u takuan përfaqësuesit e ministrive të brendshme nga Europa qendrore dhe juglindore në Sarajevë, për të marrë masa kundër refugjatëve ilegalë dhe për të rritur bashkëpunimin, shkruan "Der Standard"

RAMA KUNDËR GARDHEVE KUFITARE

Ministri i brendshëm boshnjak Dragan Mektiq foli me përfaqësuesit e tjerë dhe austriakë, duke u premtuar shkëmbimin e informacioneve rreth refugjatëve.

Gjatë kohës kur europianët diskutonin për marrëveshjen mes njëri-tjetrit, Turqia bëri të ditur prishjen e marrëveshjes së ripranimit të refugjatëve me Greqinë, pasi kjo e fundit nuk i dorëzon ushtarët e akuzuar për Grusht shteti në Turqi. Marrëveshja me BE-në mbetet në fuqi.

Në Bosnjë janë rregjistruar 5000 refugjatë, prej të cilëve gjysma ndodhen në vend. Autoritetet boshnjake kanë frikë se iranianët që udhëtojnë pa viza në Beograd, mund të vijnë në Sarajevë si emigrantë.

Si fillim, BE e ka ndihmuar Bosnjën me 1.5 milion euro. Tema e refugjatëve ka tensionuar përsëri Europën. Sipas medias kroate Jutarnji List, ministria e brendshme në Zagreb ka kritikuar presionet nga Austria, veçanërisht planin për të dërguar ushtrinë në kufi.

"Ne ia kemi bërë të qartë Austrisë, se duhet të jenë të qetë dhe konstruktivë," tha një përfaqësues i ministrisë për Jutarnji List. Kroacia thotë se nuk ka nevojë për ushtri, por vetëm shtim të numrit të policëve.

Kancelari austriak Sebastian Kurz (ÖVP) të mërkurën u shpreh: "Kemi arritur marrëveshjen me qeverinë shqiptare, që do kenë mbështetje nga ana jonë me policë nga Austria dhe pajisje përkatëse." Megjithatë në pyetjen e Standard për drejtorin e kabinetit të ministrisë së brendshme shqiptare, Adriatik Mema, në lidhje më këtë thotë: "Unë mund të vërtetoj, që nuk ka kërkesë nga Shqipëria, që policët austriakë të vijnë drejt Shqipërisë."

Megjithatë Mema theksoi se ka nevojë për pajisje elektronike më të sofistikuara për të mundësuar kontrollimin më të mirë të kufirit. Nga Frontex momentalisht janë vetëm dy ushtarë në Shqipëri. Politikanët shqiptarë theksojnë se ky problem është më i vogël sesa paraqitet.Momentalisht në Shqipëri ndodhen 2400 refugjatë nga Siria, Pakistani tha kryeministri Edi Rama për gazetarët austriakë në Tiranë.

"Ne nuk duam të ndërtojmë gardhe," vijoi Rama. "Çfarë ne kemi nevojë, është një "gardh" nga bashkëpunimi."

Belgjika njeh zyrtarisht patentat e Shqipërisë

Autoritetet belge kanë konfirmuar zyrtarisht njohjen e lejeve të drejtimit të lëshuara nga autoritetet shqiptare.
Praktikisht, nëse një shtetas shqiptar shkon në Belgjikë për më pak se 3 muaj, ai mund të përdorë lejen shqiptare të drejtimit të automjetit. Për shtetasit shqiptarë me qëndrim më të gjatë, duhet të paraqiten në komunën belge ku janë regjistruar për tu pajisur me leje belge për drejtim automjeti, bazuar në lejen e tyre shqiptare të drejtimit të automjetit.

Tirana synon të ketë 1 milion vizitorë në vit

Ambicia jonë është që Tirana të kapë 1 milion këtë vit. Pra, të kemi aq turistë sa kemi edhe banorë", është shprehur Veliaj. Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, është kthyer në një destinacion mjaft të rëndësishëm turistik, ku mund të gjesh përditë turistë nga rajoni, Evropa si dhe mbarë bota. Kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak theksoi se në 4-mujorin e parë të këtij viti kryeqyteti shqiptar është vizituar nga 300 mijë turistë dhe se qëllimi i bashkisë është që të arrihet deri në 1 milion deri në fund të vitit. "Ambicia jonë është që Tirana të kapë 1 milion këtë vit. Pra, të kemi aq turistë sa kemi edhe banorë", është shprehur Veliaj, shkruan "ATSH". Në funksion të turistëve dhe banorëve të kryeqytetit bashkia do të vendosë në përdorim edhe 4 mijë biçikleta të reja.

Kosova e fundit në rajon në Indeksin e Paqes, Shqipëria fiton 5 vende

Një vit më parë Shqipëria renditej e 57-ta mes 163 vendeve si më paqësore, sipas Global Peace Index (Indeksi Global i Paqes), por këtë vit ajo ka fituar edhe 5 vende, duke u renditur për 2018 në vendin e 52-të, ndërsa Kosova ndodhet në vendin e 92-të dhe është e fundit në rajon në këtë indeks.

"Shtatë nga tetë vendet me përmirësime të mëdha janë në Europën Lindore: Maqedonia, Mali i Zi, Sllovakia, Shqipëria, Kroacia dhe Rumania. Të gjitha, përveç Rumanisë, kanë regjistruar përmirësime në fushën e sigurisë dhe të gjitha përveç Malit të Zi kanë pasur rënie të konflikteve të jashtme. Shumica e këtyre vendeve ndajnë përmirësime si në nivelin politik dhe në luftën ndaj konflikteve të jashtme", thuhet në raportin e Global Peace Index.

Ajo që vërehet është se nga vendet e rajonit, Kosova renditet e fundit (në pozitën e 92-të), ndërkohë që vihet re shqetësimi në rritje i nacionalizmit në Europën Perëndimore.

KOSOVA NË INICIATIVËN KUNDËR TERRORIZIMIT

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Naim Rexha, i shoqëruar nga një zyrtar i Drejtorisë Kundër Terrorizmit, kanë marrë pjesë në një konferencë rajonale kundër radikalizmit të dhunshëm, të mbajtur në Brdo të Sllovenisë.

Në konferencën përmbyllëse të projektit për ndërgjegjësimin dhe inkurajimin e institucioneve për rritjen e kapaciteteve në këtë kuadër, në Ballkanin Perëndimor, morën pjesë drejtorët e policive të vendeve të rajonit si Kosova, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Sllovenia, Serbia dhe Shqipëria.

Sipas një komunikate të Policisë, gjatë konferencës u prezantua projekti i cili është pjesë e nismës së iniciativës kundër terrorizimit në Ballkanin Perëndimor, si dhe u diskutua për fluksin e migrimit në tërësi.

"Konferenca rezultoi edhe me shkëmbimin e eksperiencave më të mira, ku të gjitha shtetet pjesëmarrëse janë të angazhuara maksimalisht për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin në të ardhmen, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të këtyre fenomeneve", thuhet në komunikatë.

BETEJA TREGTARE BE-SHBA NË FOKUS TË DISKUTIMEVE TË G7

Presidenti francez, Emmanuel Macron i ka bërë thirrje presidentit amerikan, Donald Trump të mos fillojë "luftë tregtare mes miqsh" dhe e ka paralajmëruar se mund të përballet me "izolim" nga grupi i shtatë shteteteve më të industrializuara (G7), nëse vendos për një gjë të tillë

Samiti i G7 ka mbledhur në Kebek të Kanadasë kryeministrat e vendeve më të industrializuara që ka filluar të premten për të vijuar të shtunën, 9 qershor. Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara si dhe Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk e Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker do të vendosen në përballjen ndoshta më të vështirë në vite, pasi SHBA ka tronditur raportet me aleatët e saj me fillimin e një lufte të ashpër tregtare.

Sinjalet e para të zemërimit janë parë gjatë kësaj jave. Presidenti francez, Emmanuel Macron do ta trajtojnë me kujdes çështjen e tarifave. Ai i ka bërë thirrje presidentit amerikan, Donald Trump të mos fillojë "luftë tregtare mes miqsh" dhe e ka paralajmëruar se mund të përballet me "izolim" nga grupi i shtatë shteteteve më të industrializuara (G7), nëse vendos për një gjë të tillë.

"Presidenti amerikan ndoshta nuk e ka problem izolimin, mirëpo as për neve gjashtë shtetet nuk është problem që të nënshkruajmë një marrëveshje nëse është nevoja", ka thënë ai para nisjes së samitit të G7-ës në Kanada, duke shtuar se ekonomitë e mëdha jashtë Shteteve të Bashkuara tani janë "forcë e vërtetë ndërkombëtare". "Gjashtë shtetet tjera të G7-ës formojnë një treg më të madh në krahasim me atë amerikan. Kjo nuk duhet të harrohet", ka shtuar Macron. Trump në anën tjetër, përmes një postimi në Twitter ka thënë se ai do të marrë pjesë në samit "për të luftuar për tregtinë e shtetit tonë" sepse "ne kemi marrëveshjet tregtare për të këqija ndonjëherë". Pas bisedimeve me kryeministrin kanadez, Justin Trudeau, ai ka thënë se gjashtë vendet e tjera anëtare janë mjaftueshëm të fuqishme dhe mund të mbijetojnë nëse Shtetet e Bashkuara vendosin të heqin dorë nga roli i tyre global. Komentet e Macronit reflektojnë tensionet për tregti, të cilat pritet të dominojnë samitin. Vendet anëtare të G7-ës kanë thënë se do të jenë të ashpra me presidentin Trump, ndonëse nuk dëshirojnë përshkallëzim të situatës. Ekonomia, rritja gjithëpërfshirëse dhe tregtia, Barazia dhe fuqizimi i grave, Siguria dhe politika e jashtme si dhe ndryshimet klimatike dhe oqeanet janë temat kryesore të diskutimit të përzgjedhura nga presidenca kanadeze.

Trump do ta ftojë Kim Jong-un në Shtëpinë e Bardhë

Presidenti i SHBA, Donald Trump dhe lideri koreanoverior Kim Jong-un priten të takohen më 12 qershor në Singapor.
Por Trump ka folur së fundmi, pas takimit me Kryeministrin japonez, Shinzo Abe, se po shqyrton mundësinë për ta ftuar Kim Jong-un në Shtëpinë e Bardhë, nëse gjithçka do të shkojë mirë në takimin e 12 qershorit. Trump u shpreh gjithashtu se në takimin me liderin e Koresë së Veriut është e mundur të arrihet edhe një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës mes dy koreve, të cilën e vlerësoi si "pjesën e lehtë" të negociatave.
Çështja kryesore që pritet të diskutohet në takimin e Singaporit është ajo e heqjes dorë të Koresë së Veriut nga armët bërthamore, por Trump pranoi se nevojitet më shumë se një takim për ta arritur këtë gjë.

Austria me 'dorë të hekurt', përjashton disa imamë

Austria do të përjashtojë disa imamë dhe do të mbyllë shtatë xhami, thuhet sipas kancelarit austriak, Sebastian Kurz. Kurz tha se lëvizjet erdhën pas një hetimi nga autoritetet e çështjeve fetare në imazhet që dolën më parë këtë vit të fëmijëve në xhami të mbështetura nga turqit duke proklamuar betejën e Luftës së Parë Botërore në Gallipoli, raportoi "Hurriyet".
"Shoqëritë paralele, islami politik dhe radikalizimi nuk ka vend në shtetin tonë", tha Kurz.
Fotot të botuara nga javorja "Falter", tregojnë disa djem të rinj me uniforma të maskuara që marshonin, përshëndetën, valëzonin flamujt turq dhe pas luanin me të vdekurit. Xhamia në fjalë u drejtua nga organizata e Shoqatave të Kulturës Turke-Islamike (ATIB), me seli në qytetin gjerman të Këlnit dhe një degë e agjencisë turke Diyanet për çështjet fetare.

Salvini: "Ilegalët" duhet të bëjnë gati çantat

Ministri populist i djathtë i Brendshëm i Italisë kërkon t'i dëbojë migrantët. Kjo nuk do të ketë sukses. Në BE populistët e bllokojnë njëri-tjetrin, mendon Bernd Riegert. Numri i azilkërkuesve dhe migrantëve që vijnë në Itali krahasuar me një vit më parë ka rënë me 75 përqind. Që prej fillimit të vitit me varka nga deti kanë ardhur vetëm 13.000 njerëz, të nisur kryesisht në Libi. Marrëveshja me Libinë, kontrollet e shtuara kufitare dhe frikësimi i migrantëve prej tyre tregojnë efektin e shpresuar nga BE dhe nga Italia. Pra kthesa është arritur shumë kohë para ndërrimit të qeverisë, shkruan DW.

Por qeveria e re populiste vazhdon të bëjë sikur po ndodh një "invazion", siç e quan atë ministri ekstremist i djathtë i Brendshëm, Matteo Salvini. Kjo thjesht është e gabuar. Është e vërtetë se në pesë vitet e fundit në Itali kanë ardhur rreth 700.000 azilkërkues dhe migrantë, por që 500.000 prej tyre të vazhdojnë të jetojnë ilegalisht midis Alpeve dhe Siçilisë, siç pohon

qeveria e re, kjo nuk është e qartë. Shumë prej këtyre njerëzve janë pranuar si azilantë, por shumë edhe janë larguar më tej në drejtim të Veriut, në Francë, Gjermani ose diku tjetër në BE. "Problemi" i paraqitur nga populistët bëhet kështu gjithnjë e më i vogël.

Organizata ndihmëse për azilkërkuesit dhe refugjatët në Romë presin që numri i të ardhurve të bjerë edhe më tej dhe që populistët ta kremtojnë këtë si fitoren e tyre, megjithëse ata kanë korrur vetëm fryte të politikës së tanishme të azilit në BE. Ministrat e Brendshëm të BE ka tri vjet që janë fokusuar te izolimi dhe frikësimi, në fillim në kufirin turko-grek, pastaj në rrugën detare për në Itali

Trump i mërzitur, nuk i lejohet të shikojë porno në Shtëpinë e Bardhë

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump është i mërzitur që atij nuk do t'i lejohet të shikojë porno në Shtëpinë e Bardhë, pohon Mika Brzezinski për "MSNBC".

"Unë e di se dikush i cili flet së fundmi rreth jetës së Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, dhe pakënaqësia e madhe e Trump që atij nuk po i lejohet të shikojë porno në Shtëpinë e Bardhë", tha Brzezinski. "Pra, merreni këtë lajm, ai është i mërzitur që nuk mund të shikojë pornografi në Shtëpinë e Bardhë".Brzezinski

këto komente kontraverse i bëri për "MSNBC Live" të enjten, ku u shfaq si mysafir për të diskutuar komentet që avokati i Trump Rudy Giuliani bëri në lidhje me mungesën e kredibilitetit të yllit për filmat e rritur Stormy Daniels në dritën e karrierës së saj.Reklamë

"Hipokrizia është befasuese", tha ai, para se të shkëmbejnë disa fjalë rreth Trumpit, raportoi "RT", transmeton Periskopi.Gjithashtu Brzezinski foli edhe për avokatin e Trump, Giulianin ndaj mos-respektit që kishte treguar ndaj Daniels."Unë nuk e respektoj një yll pornografie ashtu siç respektoj një grua karriere apo një grua me thelb apo një grua që... nuk do ta shesë trupin e saj për shfrytëzim seksual", tha ai.

AMBASADORI HYSA PËR AKADEMIKUN E NDJERË

MATEVSKI, AKADEMIKU ME NJOHJE ERUDITE

Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga me propozim të gazetës KOHA dhe përmes ambasadës së Kosovës e kishte dekoruar akademik Matevskin për kontributin e dhënë në bashkëpunimin me kulturën e Kosovës dhe afrimin e saj me kulturën në Maqedoni

Shkup, 8 qershor - Ambasadori i Republikës së Kosovës në Maqedoni, Ylber Hysa nëpërmjet një memoriami ka përkujtuar veprat madhore të akademik Mateja Matevski, i cili të enjten, në moshë të shtyrë, ndërroi jetë.

"Si ambasador i Kosovës kam pasur mundësi shpeshherë të bisedoj haptazi me të ndjerin Mateski në një shqipe arkaike e dialektore të Rekës, siç thoshte vet ai, por që unë e quaja një shqipe të kulluar me një tingull të veçantë. Matevski me kishte treguar për paraardhësit e tij. Pretendohej që mbiemrin e kishte me origjinë nga Mati. Më tregonte për familjarët e tij që ende i kishte në varrezat në Stamboll, për punën e jetën e tyre komunitare si kurbetxhinj atje. Kishim evokuar shume miqësi e takime me intelektualë shqiptarë. Kishin shokë të përbashkët poetë kosovarë me atin tim të ndjerë, sikurse Ali Podrimën dhe Fahredin Gungën. Ky i fundit, gjatë një ekskursioni në takimet tradicionale poetike të Strugës, i kishte shpëtuar jetën Mateskut me kolegë kur aksidentalisht u ishte rrotulluar barka mbi liqe. Matesku ishte krenar me poezinë që ishte përkthyer në shqip. Ma kishte dhuruar librin me kënaqësi", shkruan ambasadori Hysa. Më kishte treguar se si shqipja e tij i kishte ndihmuar në disa situata në vende të ndryshme. Kishte mundur të bisedonte me një nga kritikët e njohur të letërsisë nga Dalmacia duke e kombinuar rekanqen e tij me atë të arbneshve të Zarës, shkruan më tej Hysa.

"Ndërsa, në një rast tjetër në Itali, në një treg të gjelbert, ku shpesh e kishte zakon të shkonte 'të shoh njerëz e zakone' siç më thoshte, me të kuptuar që shitësi fliste me gruan e tij arbërisht, ja kishte kthyer pazarin shitësit në shqipen e tij. Ndihej shumë natyrshëm kur mi tregonte gjitha këto në bisedimet tona të gjata në katër sy".

Matesku, shkruan Hysa, kishte një qetësi të brendshme imponuese, por njëkohësisht një gjerësi e njohje erudite.

"Isha i privilegjuar që e kam njohur dhe që në emër të kosovarëve e albanofonëve munda ti përcjell një mirënjohje modeste për kontributin e tij jomodest. I qoftë i lehtë dheu e u preftë në qetësi", shkruan në fund ambasadori Hysa. Ndryshe, ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga me propozim të gazetës KOHA dhe përmes ambasadës së Kosovës në Maqedoni e kishte dekoruar akademik Matevskin për kontributin e dhënë në bashkëpunimin me kulturën e Kosovës dhe afrimin e saj me kulturën në Maqedoni.

Mateja Matevski: Letërsia i afron popujt

Me rastin e vdekjes së poetit të madh Mateja Matevski, për lexuesit e gazetës sonë po risjellim, me pak shkurtime, një intervistë që gazetarja dhe poetja Delvina Kërluku e pat bërë me të, më 18 janar 2017

Mateja Matevski padyshim është një nga poetët më të shquar të poezisë bashkëkohore maqedonase. Është një nga ata shkrimtarë që për gjashtë dekada që arriti të qëndrojë në majat e kësaj letërsisë. Ndonëse në moshë të shtyrë, Matevski vazhdon shkruajë dhe së shpejti pritet që disa nga dorëshkrimet e tij ta shohin dritën e botimit. Njëkohësisht ai është shumë produktiv edhe në lëmin e përkthimeve.

KOHA: Krijimtaria është mision i mundshëm, por nuk ecën rrugës së shtruar me lule. Rruga kaq e gjatë krijuese, më shumë Ju ka "lodhur" apo Ju ka shkaktuar kënaqësi?

MATEVSKI: Përparësia dhe vlera e shkrimit në vete përmban shumë emocione nga ideja e parë deri te pika e fundit. Dhe gjithë kjo është ndërthur dhe i jep qëllimit shumë gëzime, për momentet e suksesshme. Ka edhe shqetësim kur nuk arrihet harmonia e synuar. Por, për mua si shkrimtar veçanërisht është pamjaftushmëria me arritjet dhe aspiratat, aq sa mundet të synohet që të arrihet harmonia sa të gjithë pretendojnë.

KOHA: Poet i nderuar, është "detyra" e misionarit ideali apo motivimi hyjnor shtylla që ju ka mbajtur kaq gjatë në fushën e krijimtarisë?

MATEVSKI: Ka shkrimtarë, të cilët lidhshmërinë e tyre me literaturën e kanë plotësuar ose mendojnë se e kanë arritur. Kjo është një mundësi e humbur. Unë thash për vete se më udhëheq pakënaqësia. Krijimin e shoh me syrin kritik për atë që është bërë. Dhe ajo kritikë përskaj riparimeve mbart ide të reja, tema dhe motive të reja dhe pasuron gjuhën dhe shprehjen poetike.

KOHA: Ju, lexuesi shqiptar u njeh përmes tri botimeve të veçanta, por edhe nga përfshirja në antologji e përzgjedhje të ndryshme në gjuhën shqipe, por edhe nga prezantimi i fundit me titullin Dhjetë poezi në dhjetë gjuhë, botuar nga dy shtëpi me renome, SEREMBE dhe ONUFRI, përgatitur nga poeti e përkthyesi Resul Shabani. A jeni të kënaqur me prezantimin dhe përkthimin në gjuhën shqipe?

MATEVSKI: Mua më gëzon shumë fakti që më kanë përkthyer dhe botuar në shumë libra dhe antologji. Në fillim veprat e mija janë përkthyer nga Adem Gajtani, në Shkup dhe në Prishtinë, pastaj Fatos Arapi, në Tiranë, por një respekt të veçantë më kanë bërë Shtëpia botuese "Serembe", në Shkup dhe "Onufri" nga Tirana, që kanë publikuar një përzgjedhje shumë të mirë të poezive. E lexoj dhe rilexoj dhe e vlerësoj shumë përkthimin e shokut tim Fatos Arapi. Interesi dhe përkushtimi i poetit Resul Shabani, i cili meriton vlerësim për dygjuhësinë e tij. Kuptohet që ai është njëri ndër poetët më të mëdhenj në Maqedoni dhe përkthyesi më i mirë, si në gjuhën shqipe, gjithashtu edhe në maqedonishte. Këtë e them me kënaqësi edhe unë. Dua të them se për Resulin poezia ime është shumë e afërt dhe e ka përkthyer me dashuri dhe përkushtim dhe me vlerë të shprehjes poetike. Urat letrare maqedonase – shqiptare që shkojnë përmes Resul Shabanit, janë të çmuara për dy literaturat. Krijimtaria e tij dhe aktivitetet e tij janë të paçmueshme për ne, për ju, për të mirën tonë, ndërsa besoj që një vend të tillë, ai do ta marrë në letërsi si autor në mesin e kolegëve shqiptarë (edhe në Shqipëri e Kosovë) edhe si përkthyes.

KOHA: Meqë Ju, përveç se përmes përkthimit, pak a shumë e keni lexuar poezinë shqipe edhe në origjinal, mund të jepni një opinion për vlerat e saj? Dhe, a është bërë mjaft në prezantimin reciprok të dy kulturave, dy letërsive, dy poezive?

MATEVSKI: Mes poetëve maqedonas kam nderin dhe privilegjin, pak a shumë të përcjell literaturën në dy gjuhë. Në shqip më pak, ndërsa në maqedonishte më shumë, sepse jam shkrimtar maqedonas dhe shkruaj në maqedonisht. Për këtë arsye nuk mund të lavdërohem që mjaftueshëm e njoh letërsinë shqiptare, veç përmes poetëve të theksuar, të afërmit, nga e kaluara dhe bashkëkohorja. Ky është mendimi im personal, ku me keqardhje them se nuk mund të prononcohem. Megjithatë, nga ajo që kam lexuar, mund të them që literatura shqiptare është një letërsi moderne, letërsi evropiane që e pasuron fondin e literaturës botërore. Dua të theksoj se patjetër duhet të shtohet numri i titujve të përkthyer nga Kosova e Shqipëria në maqedonishte dhe anasjelltas. Letërsia i afroj popujt. Përmes kontakteve të përbashkëta, takimeve të përbashkëta, projekteve. Veçanërisht më gëzon fakti që në këtë moment realizohet shkëmbimi i antologjive të poetëve akademikë të Kosovës dhe të Maqedonisë, që pritet të botohen së shpejti. Përzgjedhës janë akademikët Ali Alu dhe Stardellov. Përkthyes i të dy antologjive, siç jam i informuar, është poeti i madh, miku im Resul Shabani. Besoj se botimi i këtyre antologjive do ndikojë për thellimin e njohjeve të poezive dhe letërsive reciproke, për çka popujt tanë kanë aq shumë nevojë.

KOHA: Do deshëm në fund një opinion Tuajin për nivelin artistik të poezisë që krijohet në Maqedoni, pasi ju jeni edhe kritikë, edhe antologjist?

MATEVSKI: Në Maqedoni shkruhet dhe botohet mjaft poezi. Sidomos nga të rinjtë. Botuesit kanë kontributin e tyre. Kuptohet që në mesin e rinjve, si dhe atyre të gjeneratave të mëhershme, ka shumë poetë të mirë. Emra të dëshmuar dhe emra që premtojnë. Poezia e sotme, është në rrugë të mirë të vazhdojë traditën e shëndoshë të kësaj poezie. Kjo ndjek trendet e njohura në poezinë moderne. Gjithashtu, ajo ndjek trendët e poezisë bashkëkohore anglosaksone, gjermane, angleze, franceze dhe të tjerave. Kjo e bën literaturën të gërshetuar në këtë kohë, me këtë realitet me këtë sensibilitet të botës së sotme dhe lexuesit të sotëm. Ajo është integruar dhe pranon edhe ndikime. Mendoj se kjo vlen edhe për pjesën e poezisë shqipe.

Atalanta nxjerr në shitje Berishën

Atalanta ka nxjerr në ankand shërbimet e mbrojtësit shqiptar, Etrit Berisha, teksa po kalon momentet e fundit me skuadrën italiane. Ata ishin pjesë e Ligës së Evropës, ndaj në sezonin e ardhshëm kanë vendosur t'i besojnë portierit të ri Gollini. Sakaq, Atalanta ka nisur të bëjë një revolucion në radhët e klubit, pasi kërkon të përtërijë ekipin dhe "gardiani" shqiptar nuk do jetë pjesë e këtij revolucioni. Kësisoj pas Bryan Krystantes, Josep Iliçiçit dhe Gomez, është vendosur që edhe Berisha të largohet. Gjithashtu, skuadra italiane i ka vendosur edhe çmimin e largimit mbrojtësit të katërkëndëshit të portës, ndaj klubet që do të interesohen për shërbimet e Berishës, duhet të paguajnë plot 8 milionë euro. Ndërkohë, e ardhmja e prishtinasit pritet të jetë përsëri në Itali, ku njëra nga skuadrat e interesuara mbetet Fiorentina por edhe Xhenoa.

ARSENALI IA CAKTON ÇMIMIN E LARGIMIT

Sipas mediave angleze, Arsenali tani i ka caktuar edhe çmimin e largimit qendërmbrojtësi t. Topçinjtë kërkojnë 35 milionë për ta lënë të lirë të largohet reprezentuesi i Gjermanisë

PESË SKUADRA TË MËDHA PAS MUSTAFIT

Shkodran Mustafi duket se po kalon ditët e tij të fundit si futbollist i Arsenalit. Mbrojtësi shqiptar nuk ka treguar formë stabile këtë edicion me klubin londinez. Ardhja në klub e Unay Emerit ka bërë që Mustafi të mendojë për tjetër skuadër. Trajneri spanjoll nuk llogarit në shërbimet e mbrojtësit shqiptar dhe po kërkon grekun Sokratis si zëvendësues të tij. Sipas mediave angleze, Arsenali tani i ka caktuar edhe çmimin e largimit qendërmbrojtësit. Topçinjtë kërkojnë 35 milionë për ta lënë të lirë të largohet reprezentuesi i Gjermanisë. Mustafi mund të vazhdoj të mbetet në Angli pasi ish skuadra e tij Everton ka shfaqur interesim për të. Në Itali janë dy skuadrat e mëdha Roma dhe Juventus që kanë rikthyer interesimin për mbrojtësin nga Gostivari. Por gjasat më të mëdha janë që Mustafi të rikthehet në elitën e futbollit gjerman. Dy skuadrat që do të luajnë në Ligën e Kampionëve Shalke 04 dhe Borussia Dortmund po e duan lojtarin shqiptar. Ekipet gjermane janë në kontakt me Arsenalin ku shpresojnë që londinezët do ta ulin çmimin e lojtarit për ta pasur më të lehtë transferimin e tij në Bundesliga.

Mustafi ka kontratë me Arsenalin deri qershor të vitit 2021. Qendërmbrojtësi më parë ka luajtur edhe te Hamburgu, Evertoni, Sampdoria dhe Valencia.

ZHVILLIME TË REJA TE SKUADRA NGA VLORA

Beqiri, zëvendës trajner dhe drejtor teknik i Flamurtarit

Shkup, 8 qershor - Jeton Beqiri rikonfirmohet si zv.trajner te Flamurtari. Ish-ndihmësi i Shpëtim Duros do të qëndrojë në Vlorë edhe pas largimit të këtij të fundit. Madje, mësohet se njëherësh drejtuesit kanë menduar që t'i besojnë edhe një rol të rëndësishëm në klub. Ai do të jetë drejtori i ri teknik i kuqezinjve. Gjërat duket që po lëvizin në klub, ndërsa në vazhdim pritet që të ketë zhvillime konkrete edhe për trajnerin. Pezull mbeten vetëm rinovimet. Edhe pse drejtuesit pëlqejnë disa lojtarë, ende nuk janë ulur në bisedime. Adis Nurkoviç, Artim Pollozhani, Emiljano Musta, Muhamet Useini dhe Goran Siljanovski pritet të ulen në bisedime, megjithatë akoma nuk ka asgjë zyrtare. Sikundër edhe dihet, tri largime ka pasur Flamurtari deri më tani. Muarem është larguar tashmë te FC Shkupi, Xhufo do të jetë pjesë e Vadarit, ndërsa Bicaj do të vijojë aventurën te Zira në Azerbajxhan. Sakaq, për afrime as që bëhet fjalë.

Hetemaj drejt transferimit te Parma

Mesfushori shqiptar Përparim Hetemaj së shpejti pritet të bëhet me skuadër të re. Hetemaj ka mbetur futbollist i lirë pasi kontrata e tij me Kievon ka skaduar me përfundim të stinorit në Serie A. Klubi italian i ka ofruar kontratë të re tri vjeçare Hetemajt. Por drenicasi ende nuk ka dhënë një përgjigje nëse do të vazhdoj me Kievon. Së fundmi në garë për mesfushorin nga Kosova është futur skuadra e madhe italiane Parma. Të rikthyer në elitën e futbollit italian, Parma synon të ndërtojë një skuadër stabile dhe e shohin Hetemajn si futbollist ideal për ta. Sipas mediave italiane 31-vjeçari ka biseduar me klubin dhe ka gjasa të mira t'i bashkohet ish-skuadrës fituese të UEFA kupës. Këtë edicion në Serie A, Hetemaj është aktivizuar në 32 ndeshje ku ka shënuar tre gola dhe ka bërë pesë asistime. Hetemaj është pjesë e Kievos që nga edicioni 2011-12. Ai më parë ka luajtur edhe për skuadra tjera si Helsinki, Tvente, AEK dhe Bresha.

Shaqiri te super skuadra e Premier ligës

Liverpuli i është shtuar listës së klubeve të Premier Ligës që janë të interesuar për Xherdan Shaqirit pas rënies nga liga të Stok Sitit. Zvicerani ka një klauzolë lirimi në kontratën e tij – që thuhet se është rreth 12 milion-13.5 milionë funte që mund të aktivizohet nëse klubi humb statusin e klubit të Premier Ligës. Shaqiri, kishte ardhur në Angli nga Interi për një shumë rreth 12 milionë funte më 2015, e ka bërë të qartë në një intervistë se nuk dëshiron të luaj në Çampionship (Ligën e dytë angleze) por do të "dëshironte të rrinte në Angli". Gatishmëria e Shaqirit ka bërë që të vihen në alarm shumë klube të Evropës dhe Premier Ligës, më Totenhemin dhe Sautemptonin – këto të fundit që janë menaxhuar nga Mark Hjus i cili e kishte marrë anësorin në Stok – janë lidhur me transferimin e 26-vjeçarit. Liverpuli është klubi që i është shtuar kësaj liste për ish lojtarin e Bajernit, për të forcuar skuadrën e Klopp në disa zona edhe pse ende nuk kanë aktivizuar ende klauzolën e lirimit të Shaqirit, sidomos nëse dështojnë për ta sjell në Anfield Nabil Fekirin e Francës.

НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në bazë të Vendimit për ndarje të Çmimit vjetor për hulumtues të rinj nr. 02-15/III-16/2011 të datës 31.03.2011 dhe O. nr. 02-15/VIII -7/2014 të datës 31 korrik 2014, ndërsa në pajtim me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kushtet për zgjedhje të punimit më të mirë dhe ndarje të Çmimit vjetor për hulumtues të rinj nr. 2927 të datës 13.04.2011, Rr nr. 7762 të datës 20.09.2012, Rr. nr. 28175 të datës 5 shtator 2014 dhe Rr. nr. 26412 të datës 30 korrik 2015, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë publikon

KONKURS PËR NDARJE TË ÇMIMIT VJETOR TË BANKËS POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2019

Për shkak të stimulimit të zhvillimit të mendimit shkencor dhe përpunimit të punimeve nga sfera e makroekonomisë dhe bankat dhe sistemet bankare, si dhe afirmimit të kuadrove të reja dhe profesionale, Banka popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtutjeshëm: Banka popullore) ndanë Çmimin vjetor për hulumtues të rinj për punim më të mirë nga sfera e makroekonomisë dhe bankat dhe sistemet bankare.

Çmimi vjetor i Bankës popullore është 100.000,00 denarë, neto.

Të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs kanë shtetasit e Republikës së Maqedonisë të moshës deri në 35 vjet. Punëtorët e Bankës popullore dhe anëtarët e Këshillit të Bankës popullore nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje në Konkurs.

Punimet parashtrohen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze. Punimi duhet patjetër të përmbajë edhe qasje ndaj ekonomisë së Maqedonisë në temën përkatëse. Punimi nuk duhet të kalojë 80.000 karaktere me vendet e zbrazëta (pa fusnotat, shtojcat, grafikonet, tabelat, abstraktin, bibliografinë, anekset) dhe është rekomanduese të ketë strukturë standarde të hulumtimit shkencor, i cili përmban pjesët themelore në vijim:

- abstrakt, si dhe theksim të sferës së hulumtimit sipas klasifikimit standard (Journal of Economic Literature - JEL);
- qasje ndaj literaturës së konsultuar nga sfera e cila hulumtohet;
- përshkrim të metodave të hulumtimit që shfrytëzohen në punim;
- analiza;
- pikëpamjet përfundimtare dhe
- bibliografia.

Një autor ka të drejtë të parashtrojë vetëm një punim.

Në Konkurs për zgjedhje të punimit më të mirë autorët kanë të drejtë të konkurrojnë edhe me punimet të cilat tash më janë publikuar, por jo para 1 janarit të vitit 2017. Gjatë parashtrimit të punimit, autori duhet të theksojë kur dhe ku është publikuar punimi.

Punimet parashtrohen deri në Bankën popullore me shenjë "Për Çmimin vjetor të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë", përmes formës elektronike, në format "word", në e-mail adresë: konkurs@nbrm.mk. Krahas punimit, autori duhet të parashtrojë edhe të dhëna biografike. Punimet e parashtruara do të kenë trajtim të materialeve me karakter të besueshëm.

Zgjedhjen e punimit më të mirë e bën Këshilli për vlerësim, i cili përbëhet nga tre persona, nga të cilët së paku njëri është person që nuk është i punësuar në Bankën popullore. Guvernatori i Bankës popullore emëron kryetarin dhe anëtarët e Këshillit për vlerësim, me vendim i cili do të publikohet në internet faqen e Bankës popullore. Këshilli për vlerësim do të kryejë zgjedhjen e punimit më të mirë në mënyrë anonime, përmes vlerësimit të punimeve të futura në konkurrencën më të ngushtë sipas kritereve në vijim:

1. Relevancë të fushës hulumtuese për rastin e Maqedonisë;
2. Përkatësi të qasjes së literaturës nga fusha e analizuar;
3. Qartësi në definimin e problemit dhe qëllimet e hulumtimit;
4. Përkatësi në përshkrimin e kontekstit dhe informacioneve (përkatësi të analizës së trendeve në fushën e analizuar në Maqedoni);
5. Përkatësi të qasjes së shfrytëzuar statistikore-ekonometrike;
6. Konzistencë dhe logjikë të tezave në punim;
7. Konkuzione dhe rekomandime dhe përkatësi të tyre.

Këshilli për vlerësim mund të ndajë çmim për punimin e dytë të shpërblyer në Konkurs në shumë prej 50.000,00 denarë, neto.

Afati përfundimtar për parashtrimin e punimeve është **1 shkurt 2019**.

Çmimi vjetor i Bankës popullore do të ndahet në evenimentin e organizuar me rastin e Ditës së pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë.

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 aalineja 7 e Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14 ,180/14, 33/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18) nenit 15 paragrafi 1 alineja 7 të Statutit të IP Qendra për punë sociale t- Krushevë dhe Vendimit të Këshillit drejtues të sjellë në mbledhjen e mbajtur më datë 07.06.2018, ndërsa të vërtetuar me numër 02-166/3 të datës 07.06.2018, Këshilli drejtues pranë IP Qendra për punë sociale – Krushevë, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra për punë sociale – Krushevë

1. Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin kushtet në vijim të përcaktuara me ligj:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Të kenë të mbaruar arsim sipëror të shkallës së VII/1 të përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK, të profileve arsimore në vijim: punëtor i diplomuar social, psikolog, pedagog, jurist,
- Të kenë minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit,
- Të parashtrojë program të përpiluar për udhëheqje me institucionin.

Neto pagesa është **26.574,00** denarë.

2. Kandidatët duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë/vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës – certifikatë ose diplomë;
- Dëshmi për përvojën e punës pas diplomimit;
- Certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet dhe
-Program për udhëheqje me institucionin

3. Dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
4. Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.
5. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të shqyrtohen.
6. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen në arkivin e IP Qendra për punë sociale – Krushevë ose përmes postës në adresën në vijim, rr. "Niko Doaga" nr. 66a (me shenjë shpallje publike për zgjedhje të drejtorit).

Vërejtje: Kandidati për drejtor i cili do të zgjidhet për drejtor deri më 01 shtator 2018 obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes.

Kandidati është e nevojshme të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet

- TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
- IELTS – së paku 6 pikë,
- ILEC (Cambridge English:Legal)-së paku niveli B2,
- FCE Cambridge English:First)-të dhënë,
- BULATS së paku 60 pikë ose
- APTIS – së paku niveli B2.

Drejtori i cili nuk do të përmbushë kushin për njohje të gjuhës angleze në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes, i ndërpritet mandati.

IP Qendra për punë sociale – Krushevë
KËSHILLI DREJTUES

Në bazë të nenit 138 nga Ligji për ndryshime dh plotësime të Ligjit për sigurim shëndetësor (Gaz.zyrtare e RM nr. 43/012) Fakulteti mediciness pranë UKM në Shkup publikon:

KOKURS
për pranimin e kandidatëve për deriedukim të punëtorëve shëndetësorë-mjek të zgjedhur të medicinës familjare për 3, 6, 9 dhe 12 muaj

Fakulteti i mediciness në Shkup pranë Universitetit "Shn.Kirili dhe Metodi:-Shkup, për vitin 2018, do të bëj pranimin e:
- 50 kandidatëve për deriedukim në qendrën për Medicinë familjare në Shkup.

Kushtet dhe kriteret për pranim në deriedukim
- Të mbaruar Fakultetin e mediciness
- Të dhënë provimin profesional
- Licencë themelore të fituar
- Stazh pune në veprimtarinë Medicinë e përgjithshme apo punë si mjek i zgjedhur minimum 14 vite (për kandidatë për 6 muaj deriedukim)
- Stazh pune në veprimtarinë Medicinë e përgjithshme apo punë si mjek i zgjedhur minimum 7 dhe14 vite (për kandidatë për 9 muaj deriedukim)
- Stazh pune në veprimtarinë Medicinë e përgjithshme apo punë si mjek i zgjedhur minimum 3 vite (për kandidatë për 12 muaj deriedukim)
- Të mbaruar provimin specialistik të mediciness së përgjithshme (për kandidatë për 3 muaj deriedukim)
- Përparësi do të kenë edukatorë në PZZ dhe mjek në mjediset rurale

Deriedukimi do të kryhet sipas programës së miratuar. Modulet njëditore do të realizohen për vikende në **Qendrën për medicinë familjare në Shkup,** pjesa praktike do të kryhet në seksionet spitalore në **Klinikat Universitare pranë Qenrës së Klinikës Shkup** dhe ambulantet e miratuara.

Afati për paraqitje: 30 ditë nda data e shpalljes së konkursit.

Dokumentet për paraqitje:
- Diplomë dhe certifikatë me nota për Fakultet të mediciness të mbaruar (naoterizuar)
- Certifikatë për provim të dhënë profesional dhe licencë themelore;
- Kopje të M1/M2 formularit nga Instituti shëndetësor në të cilën kandidati është i punësuar
- Vërtetim për përvojë pune (nga libreza e punës apo certifikatë nga Agjencioni për punësim)
- Vërtetim nga mjeku i cili do ta zëvendësoj kandidatin derisa kandidati është në deriedukim.
- Kopje (verifikuar) nga certifikata për provim të dhënë specialistik të mediciness së përgjithshme (për kandidatë për 3 muaj deriedukim)

ME RËNDËSI: Deriedukimi do të fillojë me 1 tetor 2018. Prej 17.09 deri 21.09.2018 kandidatët e zgjedhur të paguajnë ratën e parë dhe të marrin vendimet nga Dekanati. Gjatë shtatorit do te formohen grupe dhe do të shpërndahen mentorë. Është e nevojshme kandidatët ta organizojnë punën e tyre që të mund pa ndërprerë ta realizojnë deriedukimin (turnus dhe vikend modulet)

Programi për deriedukim mund të gjendet në www.semejnamedicina.mednet.mk

NGA FAKULTETI MEDICINËS PRANË UKM - SHKUP

Në bazë të nenit 60 paragrafi 1 alineja 5 dhe nenit 62 dhe 64 të Ligjit për standard të nxënësve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 52/05) dhe ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për standard të nxënësve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 117/08, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15, 30/16 dhe 64/18) dhe Vendimit të kryetarit të Komunës Veles me numër 08-97/3 të datës 04.06.2018, Këshilli drejtues i SHF "Llazar Llazarevski" – Veles, publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të SHF "Llazar Llazarevski" – Veles

1. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet për edukator dhe bashkëpunëtor profesional për punë edukativo-arsimore, të kenë të mbaruar arsimin e lartë dhe së paku pesë vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe provim të dhënë për drejtor të shkollës fillore ose të mesme publike.

2. Kandidatët së bashku me lutjen duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim;
-Biografi të shkurtë (CV),
-Diplomë për arsim sipëror të mbaruar me minimum 240 SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit,
-Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të shkollës fillore ose të mesme publike,
-Vërtetim për përvojën e punës në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës,
-Certifikatë të shtetësisë,
-Certifikatë të mjekut,
-Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- drejtori i cili zgjidhet në periudhën prej 19 prill 2018 deri më 1 shtator 2018, obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij (të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS - së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku nivelin B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2),
-Program të punës për drejtor,

Dokumentet e nevojshme kandidatët i parashtrojnë në këshillin drejtues të SHF "Llazar Llazarevski" – Veles në zarf të mbyllur përmes postës në adresën: rr. "D-r Hristo Tatarçev" nr. 3 Veles se në arkivin e shkollës çdo ditë pune prej ora 08.00 deri në ora 12.00.

Në afat prej pesë ditëve pas përfundimit të shpalljes komisioni do të shqyrtojë dokumentet e arritura dhe pas intervistës së realizuar do të parashtrojë propozim deri tek Kryetari i Komunës së Velesit.

Shpallja zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor të Republikës së Maqedonisë.

Këshilli drejtues i SHF "Llazar Llazarevski" – Veles

Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 alineja 7 dhe 8 nga Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e RM nr. 79/09,36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14 ,180/14, 33/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18) nenit 23 paragrafi 1 alineja 3, 4 dhe 7 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 120/11, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16) dhe nenit 21 paragrafi 2 të Statutit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit nr. 01-1274/6 të datës 06.07.2015, Këshilli drejtues pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit në mbledhjen e mbajtur më datë 07.06.2018, sjellë

VENDIM
Anulohet shpallja publike për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit

1. Anulohet shpallja publike për zgjedhje të drejtorit IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit të publikuar më datë 05.06.2018 (e martë), në gazetat ditore "Nova Makedonija", "Slloboden Peçat" dhe "Koha".
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën kur është sjellë.

Kryetar i Këshillit drejtues
Vladimir Bislimovski

DUHET TA FITOJMË BOTËRORIN, PËRNDRYSHE S'KA KUPTIM

Eden Hazard thotë se Belgjika duhet të fitojë Kupën e Botës me grupin e tanishëm të lojtarëve, ose gjenerata e tyre e artë do të konsiderohej dështim. Shumë prej njerëzve e presin këtë, në fakt, nisur nga përbërja e talentuar dhe me lojtarë nga të gjitha ligat më të mëdha të Evropës. Hazard, Romelu Lukaku & CO shkuan deri në çerekfinale të Kupës së Botës 2014, bënë paraqitje mbresëlënëse edhe në "Euro 2016", në evenimentin më të fundit në skenën ndërkombëtare, dhe po kërkojnë të shkojnë më tutje këtë vit, për të treguar se përbëjnë një ekip historik belg. "Ne e dimë se çfarë jemi. Kemi lojtarë të mirë, të gjithë luajmë në kampionate të mëdha; në Angli, Itali dhe Spanjë, kështu që e dimë se çfarë duhet të bëjmë, – u tha Hazard gazetarëve. – Ne kemi pasur një brez të tillë të artë edhe 10 apo 15 vite më parë, por nuk kemi fituar asgjë. Tani mendoj se tifozët, gazetarët, e gjithë Belgjika, thjesht duan të fitojnë diçka. Ne kemi një brez të artë, prandaj duam të fitojmë diçka tani. Sigurisht që jemi shumë të ngazëllyer për Kupën e Botës, si gjithmonë. Do ta luajmë ndeshjen e parë për 10 ditë, kështu që vetëm duam të jemi atje dhe të luajmë. Ne jemi në përgatitje, por do të jemi gati për Kupën

Botërore, kur të fillojë".

Belgjika e fillon turneun e verës në Rusi në një grup të përbërë nga Panama, Tunizia dhe Anglia. Eden Hazard është duke shikuar përpara, për të takuar disa fytyra të njohura në përplasjen në Kaliningrad. "Kjo do të jetë një lojë e veçantë për ne, por së pari kemi dy ndeshje të tjera, kundër Panamasë dhe Tunizisë, ndërsa ndaj Anglisë do të jetë e treta e vërteta, – shtoi ai. – Ndoshta në të kaluarën Anglia futej te favoritët, por tani është ndryshe. Mendoj se jemi mjaft të njëjtë 50 me 50. Anglia ka shumë lojtarë të mirë, edhe ne, gjithashtu, kështu që do të shohim. Më pëlqen të jem kapiten, natyrisht, jam një lider në fushë, por në ekip kemi shumë lojtarë që mund të flasin, mund të thonë diçka. Unë nuk jam kapiteni i vetëm, përpiqem të bëj më të mirën dhe të jem lider në fushë", përfundoi Hazard.

Egjipti do të stërvitet në qytetin e çeçenëve - Grozni

Një njoftim zyrtar është bërë gjatë mbrëmjes së djeshme ku është konfirmuar që Mohamed Sallah dhe Egjipti do të stërviten në shtëpinë Bekim Balës, Odise Roshit dhe Bernard Berishës. Ekipi kombëtar i Egjiptit ka zgjedhur si bazë për trajnimin e ekipit kombëtar gjatë Botërorit, qytetit e Groznit, i cili është kryeqyteti i çeçeneve dhe për fat të keq nuk do të pres asnjë ndeshje të Kupës së Botës. Kjo qendër stërvitore është ngjitur me stadiumin ku stërviten çdo javë futbollistët shqiptarë me skuadrën e tyre. Ramzan Kadirov është lideri i çeçeneve, i cili ka kërkuar me ngulm që të kishte të paktën një ndeshje të Botërorit të zhvilluar në stadiumin e Groznit, por të gjitha ekipet kombëtare perëndimore e refuzuan këtë kërkesë. I vetmi ka qenë Egjipti, i cili e ka pranuar menjëherë. Ky është një fat i madh për egjiptianët, të cilët do të kenë në kokë të gjithë shtetit për t'i ruajtur dhe t'i shërbyer lojtarëve, kryesisht yllit të tyre Mohamed Salah.

Publicitet

АФПЗРР AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelim të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15 dhe 39/16), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2018

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në Peshkatari dhe Akuakulturë për vitin 2018

I. LËNDA E SHPALLJES PUBLIKE

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për nenpikat për masat në vijim:

Masa 1	*Përkrahja financiare në peshkatari*	*Mjete*	*Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme*
Nënpika 1.3	Pikat e peshkimit-ndërtimi i të rejave, rikonstruimi dhe adaptimi i pikave ekzistuese të peshkimit, kompensim i shërbimit për shfrytëzim të pikave ekzistuese	**1.000.000,00 denarë**	
Nënpika 1.4	Përkrahje financiare për rehabilitim të ujrave për pershkim me zgjerim, mbindërtim dhe pajisje e kapaciteteve ekzistuese/baseneve për prodhim e materialit riprodhues dhe për shumim të peshkut.	**1.500.000,00 denarë**	
Nënpika 1.5	Ndërtimi dhe rikonstruimi mandrave për peshkim tradicional në liqenin e Dojranit	**1.000.000,00 denarë**	

Masa 2	*Përkrahja financiare në akvakulturë*	*Mjete*	*Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme*
Nënpika 2.1	**Përkrahje financiare për investime na akuakulturë**	**10.000.000,00 denarë**	**7.000.000,00 denarë për shfrytëzues individual**
	- Ndërtimin e kapaciteteve të reja në akuakulturë		
	- Zgjërimi, rikonstruimi, adaptimi dhe modernizimi I kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë		
	- Ndërtimin e kapaciteteve të reja për përpunimin e peshkut		
	- Furnizim me pajisje për përpunim, deponim dhe paketim të peshkut		

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për nënpikat:

Subjekt	Nënpika
Njësi të vetëqeverisjes lokale për ndërtimin e pikave të reja, rikonstruimin dhe adaptimin e pikave ekzistuese për peshkim, ndërsa shfrytëzues të mjeteve për shërbim për shfrytëzim të pikave ekzistuese janë koncesionerë të peshkut.	1.3
Reproqendra të regjistruara për prodhim të materialit reproduktiv dhe shumim	1.4
Njësia e vetëqeverisjes lokale ose koncesionerët e peshqve për kryerjen e peshkimit shoqëror në Liqenin e Dojranit.	1.5
Shfrytëzuesit e mjeteve të dedikuara për ndërtimin e kapaciteteve për akuakulturë janë: Subjekte që janë të regjistruara për veprimtari për akuakulturë dhe të cilët posedojnë apo shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilën planifikojnë të ndërtojnë kapacitet për akuakulturë; ose posedojnë leje për shfrytëzimin e ujërave për vendosjen e kafazeve në zonat e parapara për akuakulturë	2.1
Shfrytëzuesit e mjeteve të dedikuara për zgjerim, rikonstruim, adaptim dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë janë: Subjekte që janë të regjistruara për veprimtarinë akuakulturë, dhe janë të regjistruar në regjistrin për kultivimin e peshkut e cila udhëhiqet në Ministrin për bujqësi, pylltari dhe ekonomizim;	2.1
Shfrytëzuesit e mjeteve të dedikuara për ndërtim të kapaciteteve të reja për përpunimin e peshkut janë: Subjekte të cilat janë në rang të mikro, ndërmarrjeve të vogla apo të mesme të cilat posedojnë apo shfrytëzojnë pronësi të patundshme në të cilën planifikojnë të ndërtojnë kapacitete përpunuese;	2.1
Shfrytëzuesit e mjeteve të dedikuara për furnizim me pajisje, përpunim, deponim dhe paketim të peshkut janë subjekte të cilat janë në rang të mikro, ndërmarrjeve të vogla apo të mesme të cilat posedojnë apo shfrytëzojnë objekt dedikuar për përpunimin e peshkut.	2.1

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet dedikohen për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, shpenzime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe shpenzime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të peshkatarisë dhe akuakulturës për vitin 2018 (Gaz.Zyrtare nr. 4/18)

Për Masën 2.1, përkrahja financiare do të paguhet në parim të bashkëfinancimit të investimeve të përfunduara dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investime. Shkalla e bashkëfinancimit ritet për 55%, 60% dhe 65% në rastet kur:

- 55% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dorëzuar nga bartës I ekonomizimit bujqësorë prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e dorëzimit të investimit apo femër bartës I ekonomizimit bujqësorë;
- 60% nga vlera e investimit të lejuar, për investime në ekonomizimin bujqësorë e cila gjendet në zonën malore kodrinore rurale;
- 65% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dorëzuar nga bartës I ekonomizimit bujqësorë prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e dorëzimit të investimit apo femër bartës I ekonomizimit bujqësorë bujqësorë e cila gjendet në zonën malore kodrinore rurale.

Përkrahja financiare e dhënë është e pakthyeshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për çdo nënpikën e veçantë dorëzohen në origjinal.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkuesit të mjeteve janë përcaktuar në Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2018 ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 4/18).

Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjete në disponim në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2018, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkuesve që kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Kërkuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të kontratës për bashkëfinancim me Agjencionin për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve" (Formular PRA-A1) së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin e shfrytëzuesve mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk,.

Formularët e lartpërmendur mund të merren dhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresën:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C) 1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për përkrahje financiare dhe pagesën e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2018 së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2018 dhe shënimin e shifrës së nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritjen jo në kohë ose të pakompletuar për arritjen në arkiv apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është më datën 09.07.2018.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paparë nuk do të merren në shqyrtim.

Informata më të detajuara në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresë: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratimin e projekteve dhe Sektori për miratimin e pagesës.

Telefoni: **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej 08:30 deri në ora 16:30.

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

Lampard thërret Terrin te Derbi Kaunti

Trajneri i ri i Derbi Kaunti, Frank Lampard, po planifikon të marrë në skuadër ish-shokun e ekipit te Çellsi, Xhon Terri, sipas asaj që bën të ditur "Derby Telegraph". Lampard ka qenë një nga miqtë më të mirë të Terri, kur luanin bashkë te Chelsea, dhe ai do të ishte përforcimi i duhur nëse një tjetër veteran, Kurtis Dejvis, largohet nga Derbi. 33-vjeçari Dejvis mund të shkojë te Stok, sepse është një nga futbollistët e preferuar nga trajneri i ri i kësaj skuadre Geri Rovett, i cili ka qenë pikërisht te Derbi në sezonin e kaluar. Nëse Dejvis do të largohet, atëherë Lampard do të përpiqet të marrë 37-vjeçarin Terri duke i dhënë shiritin e kapitenit. Paga e Dejvis, 3 milionë sterlina në sezon, do të kalonte për Terrin, i cili aktualisht është te Aston Villa dhe ka pasur oferta nga Kina dhe SHBA.

SIPAS GAZETARIT SPORTIV ITALIAN XHANLUKA DI MARZIO

KONTE KA REFUZUAR STOLIN E REAL MADRIDIT

Megjithëse trajneri i "Blues" është i pakënaqur me sjelljen e drejtuesve të klubit nga "Stamford Bridge", të cilët kanë lejuar zërat për dikë tjetër, që mund ta zëvendësojë, pa i përgënjeshtruar asnjëherë, Konte heziton të japë dorëheqjen me një vit të mbetur në kontratën e tij

Trajneri italian i Çellsit, Antonio Konte, ka hedhur poshtë mundësinë e drejtimit të Real Madridit, pas largimit të Zinedin Zidan dhe interesimit të krerëve të klubit kampion të Evropës. Ky është lajmi i publikuar nga gazetari i njohur sportiv italian, Xhianluka Di Marzio. Megjithëse trajneri i "Blues" është i pakënaqur me sjelljen e drejtuesve të klubit nga "Stamford Bridge", të cilët kanë lejuar zërat për dikë tjetër, që mund ta zëvendësojë, pa i përgënjeshtruar asnjëherë, Konte heziton të japë dorëheqjen me një vit të mbetur në kontratën e tij. Largimi i Zinedin Zidan nga "Santiago Bernabeu" i ofroi ish-trajnerit të Juventusit dhe Italisë mundësinë e largimit nga perëndimi i Londrës, por Antonio Konte nuk është i sigurt nëse skuadra aktuale e Real Madridit do të jetë e hapur ndaj metodave të tij intensive të stërvitjes. Ja lajmi i plotë i Di Marzio, që shquhet për vërtetësinë e atyre që publikon.

"Real Madridi ka kontaktuar me Konten, por ai dëshiron ta respektojë kontratën me Çellsin. Në orët e fundit ka pasur kontakte mes Real Madridit dhe trajnerit italian. Një sugjerim i nisur nga gazetat e huaja, por tani për tani nuk është i zbatueshëm, duke pasur parasysh dëshirën e ish-trajnerit të Italisë për të respektuar marrëveshjen e tij me Çellsin. Real Madridi ka identifikuar te Konte profilin më të mirë për të zëvendësuar Zidanin, por refuzimi erdhi nga trajneri i bluve të Londrës. Ish-trajneri i kombëtares italiane përsëriti parimin e tij: nuk ka marrë komunikime nga Çellsi (për një shkarkim të mundshëm) dhe nuk ka ndërmend të marrë ai hapin e parë. Një pozicion që është bërë shqetësues më shumë për atë që është shkruar dhe thënë në media, se sa nga komunikimet e vërteta të bordit drejtues të "Blues", çka e ka mërzitur mjaft trajnerin italian.

Dyshimi kryesor i Kontes për stolin e mundshëm të Real Madridit do të ishte situata e vet, duke udhëhequr një grup jo të gatshëm për ato, që janë metodat e tij të punës. Një dhomë zhveshjeje në fakt është formuar dhe ndoshta nuk është e gatshme për të mirëpritur një trajner, me metoda të forta dhe vendimtare. Pra, duket e vështirë për të arritur një marrëveshje, të paktën për momentin", shkruan në lajmin e Di Marzio.

UEST HEMI NUK HEQ DORË

Ofron 35 mln euro për Felipe Anderson

Klubi anglez Uest Hem nuk heq dorë nga synimi për të nënshkruar me Felipe Anderson të Lacios. Javën e ardhshme një delegacion i "Hummers" do të udhëtojë drejt Romës për t'u takuar me përfaqësuesit e klubit bardhekaltër, me shpresën se do të gjejnë marrëveshjen e shumëpritur. Trajneri Manuel Pelegrini, duke parë vështirësitë për të mbërritur të Havier Pastore (ka pagë shumë të lartë), ka vendosur të investohet te 25-vjeçari brazilian, duke u ofruar lacialëve plot 35 milionë euro, plus bonuset. Mësohet se menaxherët e futbollistit kanë marrë miratimin e drejtuesve të Lacios për të vijuar bisedimet, por largimi i tij do të lejohet vetëm për një ofertë të mirë. Felipe Anderson pëlqehet shumë edhe nga Çellsi, por Uest Hemi në këto momente është ndjeshëm në avantazh ndaj bluve të Londrës.

LIVERPULI I PANDALSHËM

Merr edhe Fekir për 60 milionë euro

Liverpuli bën një tjetër goditje në merkato, pas blerjes së Fabinjos vetëm pak ditë më parë. "The Reds" kanë siguruar shërbimet e sulmuesit të Lionit, Nabil Fekir për 48 milionë sterlina plus 4.5 milionë të tjerë që do të paguhen në formën e bonuseve. Një marrëveshje që kushton thuajse 60 milionë euro për klubin anglez, që arrin të sigurojë një nga elementët më të spikatur të futbollit francez. Gjatë sezonit të aktual Fekir ka mundur të shënojë 28 gola si dhe ka dhënë 8 asistime në 40 ndeshje që ka zhvilluar me Lionin. Gjatë orëve në vazhdim pritet që futbollisti të kryejë vizitat mjekësore. Sulmuesi i lindur në vitin 1993 është i grumbulluar me përfaqësuesen e Francës për Botërorin "Rusi 2018", ku pritet të bëjë edhe debutimin e tij në këtë kompeticion madhor.

RRI APO LARGOHET NGA INTERI?

Ausilio sqaron të ardhmen e Ikardit



Goditjet e deritanishme janë De Vrij, Martinez dhe Asamoah, me parametra zero, por merkatoja e Interit nuk ndalet këtu. Këto lëvizje të para të kësaj vere i bëjnë zikaltrit një nga ekipet më aktive në këtë drejtim, teksa dihet se deri më 30 qershor, që është afati i fundit i dakorduar me UEFA-n, Interi duhet të regjistrojë fitimet kapitale prej 40 milionë euro. Ky kriter do të ishte plotësisht i përmbushur në rastin e transferimit të Mauro Ikardi, por drejtori sportiv, Piero Ausilio, mohoi zyrtarisht shitjen e sulmuesit argjentinas. Këtë e nënvizoi për mediat e mbledhura para një restoranti në Milano. "Ikardi nuk do të lëvizë, e them këtë në mënyrën më të fuqishme. Nainggolan? Mua nuk më pëlqen, por Spaleti e njeh mirë, pasi e ka drejtuar te Roma. Oferta e Napolit për Handanoviç? Kjo nuk është e vërtetë fare. Situata e Rafinja? Shpresa vdes e fundit", ka sqaruar Ausilio. Ndërkohë, Milan Skriniar, sipas "La Gazzetta dello Sport", do të lidhet me zikaltrit deri në vitin 2023 (një vit më shumë se data e saj aktuale skadimit të kontratës) dhe do të fitojë 2.2 milionë euro në sezon. Po ashtu, te zikaltrit janë duke pritur rinovimin e Ikardit, i cili mund të hyjë në fuqi deri në vitin 2023, me rritjen e klauzolës së lirimit ë kontratë, e vlefshme vetëm për jashtë vendit. A ardhmja me Interin është parashikuar edhe për Miranda, për të cilin është propozuar një zgjatje kontrate deri më 2020, përveç Santon dhe Kandreva (2021).

DASHI 21. mars - 20. prill

Jeta juaj ne çift do jete me e kënaqshme gjate kësaj dite. Do keni me tepër kohe te lire dhe do qëndroni me tepër me atë qe dashuroni. Ambienti do jete romantik. Beqaret do takojnë rastësisht një person për te cilin do iu rrahe zemra shume fort. Ne planin financiar duhet te reflektoni me kujdes para se te hidhni çdo lloj hapi. Nuk është koha për te kryer investime marramendëse.

DEMI 21. prill - 21. maj

Keqkuptimet ne çift do jene te shumta gjate kësaj dite dhe për pasoje debatet nuk do kenë te ndalur. Do trishtoheni se tepërmi nga atmosfera qe do krijohet dhe nuk do dini çfarë te bëni me pare. Beqaret do jene me te qarte për atë qe duan te bëjnë dhe do ia plotësojnë dëshirat vetes. Fale ndikimit te Diellit ne planin financiar situata do filloje te përmirësohet.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do jeni mjaft sensuale gjate kësaj dite dhe do e bëni partnerin te ridashurohet me ju. Ne mbrëmje emocionet do jene akoma me te forta sesa mendonit. Beqaret duhet ta heqin turpin dhe te bëjnë ato qe ndiejnë pa menduar se çfarë do thonë te tjerët. Ne fund te fundit është jeta juaj. Financiarisht do keni goxha ndryshime. Dikush do iu ndihmoje me një shifër te konsiderueshme.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Partneri ka shume mundësi t'iu beje një propozim serioz gjate kësaj dite dhe gjithçka do ndryshoje për ju. Mendohuni mire para se te jepni përgjigjen përfundimtare. Beqaret duhet te mos nxitohen te krijojnë menjëherë një lidhje, por te njihen mire me personat qe do takojnë. Ne planin financiar asgjë nuk do shkoje ashtu si keni dëshiruar, kështu qe bëni kujdes.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite shume e qete dhe pa asgjë te veçante kjo e sotmja për te dashuruarit. Shfrytëzojini për te folur seriozisht mbi disa tema qe iu kane shqetësuar prej kohesh sepse partneri do jete me i gatshëm për te bashkëpunuar. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare. Ne planin financiar do kryeni operacione te rëndësishme financiare. Gjendja do jete e qëndrueshme.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Çiftet do shkojnë neper festa te këndshme te organizuar nga miqtë dhe do kalojnë momente me te këndshme ne krahët e partnerit. Nëse jeni beqare do filloni aventura kalimtare gjate kësaj dite, por emocionet do jene me te vërtetë te papërshkrueshme. Financat nuk do jene te mira. Do iu duhet shume mund she sakrifica për ta stabilizuar situatën.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Dite e mire për te sqaruar te gjitha mosmarrëveshjet me partnerin gjate kësaj dite. Te dy do i kuptoni gabimet qe keni bere dhe do premtoni qe nuk do i përsërisni kurrë me. Beqaret duhet te ndryshojnë pamjen e tyre nëse duan te bien ne sy. Ne planin financiar do rrezikoni shume po kryet investime te pamatura. Situata ka rrezik edhe t'iu dale jashtë kontrollit.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Beni shume kujdes me xhelozinë e tepruar gjate kësaj dite sepse atmosfera ne çift mund te ndërlikohet se tepërmi. Tregohuni me tolerante dhe te kuptueshëm. Beqaret do pëlqejnë shume persona, por asnjeri nuk do interesohet për ta. Ne planin financiar nuk duhet te ndërmerrni rreziqe te mëdha vetme për ta përmirësuar situatën sepse mund te humbni me shume sesa mendoni.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Nëse jeni ne një lidhje duhet te prisni edhe disa dite para se te merrni vendime te mëdha. Sot nuk është momenti i duhur, kështu qe bëni gjerat e zakonshme. Beqaret do ndeshen me një person joshës, por qe ne te vërtetë nuk vlen aspak. Mos shikoni vetme pamjen e personave. Ne planin financiar duhet te reflektoni njëqind here para se te bëni çdo shpenzim.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Edhe gjate kësaj dite do përballeni me vështirësi te shumta ne jetën tuaj ne çift dhe debatet nuk do kenë te sosur. Si ju ashtu edhe partneri do tregoheni kokëfortë dhe nuk do toleroni aspak. Beqaret do kenë vetme takime pa te ardhme. Financat do kërkojnë me tepër përkujdesje dhe maturi. Nëse nuk zbatoni disa rregulla do keni probleme serioze.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Dite harmonike dhe e mbushur me gëzim kjo për gjithë te dashuruarit. Askush nuk do arrije ta prishe atmosferën e ngrohte dhe ju do dashuroheni ashtu si do e ndjeni. Beqaret nuk duhet t'i besojnë askujt sot sepse do lëndohen pa mase. Financat nuk do kenë asnjë problem. Situata do jete përgjithësisht e qëndrueshme dhe nuk do keni për çfarë te qaheni.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Marsi do jete planeti me i favorshëm gjate kësaj dite për jetën tuaj ne çift. Ai do iu nxite te tregoheni me tolerante me partnerin dhe t'i pranoni edhe gabimet qe do bëni. Nëse jeni ende beqare duhet te mos iu besoni te gjithë personave qe do iu vijnë rreth e rrotull. Ne planin financiar mos bëni sakrifica te mëdha për te përmirësuar buxhetin sepse po gabuat do humbni shuma marramendëse.



HORIZONTALISHT : **1.** Pjesëtar i kastës ushtarake të feudalëve japonez; **7.** Poet te grekët e lashtë (shq.); **8.** Zog grabitqar; **10.** Politikan hungarez, Jozef; **11.** Majat e mprehta të një mali; **13.** Shurtesë për-hektar; **14.** Lloj ëmbësire si bakllava; **16.** Shkruaj: Ll. E.; **17.** Aktorja françeze, Anuk; **19.** Tenisti françez, Janik; **20.** Lloj ecjeje kali; **21.** Martesa me dy gra njëkohësisht; **24.** Aktorja amerikane, Greta; **26.** Jeta e qetë dhe e lumtur; **28.** Fizikani gjerman, Maks; **29.** Qytet i shenjtë mysliman; **30.** Stopime.

VERTIKALISHT: **1.** Term në tenis; **2.** Perëndia e erës në mit. Sumere; **3.** Kandërr e vogël, thnegla; **4.** Lavdrimi i një malli; **5.** Pjesë lirike për një zë; **6.** Lloj kafshe përtypëse aziatike; **7.** Emri i vjetër i Vietnamit; **9.** Ndeza (krah.); **10.** Harmoni, argëtim; **12.** Prova, eksperimenti; **15.** Mbreti i gjarpërinjëve; **18.** Qytet në Jordani; **20.** Barkë e vogël; **22.** *Internat. Bank for Reconstruct. and Development;* **23.** Gjë e njëjtë; **25.** Antonio Banderas; **27.** Notë muzikore.

MË DATË 4.06.2018 NDËRROI JETË,

MUHAMED HYSA

Jurist, gjykatës, avokat disa vjeçar
në qytetin e Dibrës.

E përkujtojnë me mall të madh, bashkëshortja Paqizja, vajza Rezehana Hysa, djali Nehat Hysa me familjen, vajza Ferizat Lata me familjen, motra Lutfija, nipat, mbesat, miqtë dhe dashamirët.

Koha Koha Koha	FUTBOLLIST ITALIAN	ISH PRESIDENTI SHQIPTAR, RAMIZ	QË KA TË BËJË ME LIMFËN	EMA TOMPSON	K. F. JAPONEZ	SHIGJETËZ E SAHATIT	FUNKSION TRIGONOMETRIK (gjeom.)
LAPSAT / VEPRIMTARIA E PUSHTETIT SHTETËROR TË NJË VENDI							
▶							
POND / LUMË NË RUSI				LUMË NË FRANCË / IMITIM QESHARAK I NJË TEKSTI PARODIA			
VALË AJRI, AVULLI, TYMI etj.					EENA GJIKA / SOUL KËNGËTARJA AMERIKANE, FRENKLIN		
AMPER		ZEZAKE / PERANDOR BIZANTIN (NGA ILIRIA) (491-518)					
EMIRAT NË LINDJEN E AFËRT						NORVEGJIA / KAPELË E MALAZEZËVE DHE HERCEGOVASVE	
GJITHËSI, KOZMOS							
	HUMORISTI YNË NGA FOTO	ZË I THELLË FEMRE	QYTET NË SHQIPËRI	MJET FLUTURIMI / KOMPOZITORI RUS, STRAVINSKI					DETYRËS, AI QË ËSHTË I DETYRUAR
SHKRIMTAR HUNGAREZ, MIHAL / ANËTARET E NJË DELEGACIONI						PIKTOR DHE SKENOGRAF, SHYQYRI / VEND KU SUNDON EMIRI			
▶								ÇARLS BRONSON / QË BËN NOT (vjet.)	
▶					LLOJ EKSPLOZIVI / GJINI LETR. QË TREGON BËMAT HEROIKE				
PREFIKS ME KUPTIM: I TRUPAVE QIELLOR, I YJEVE / ITALIA		PERËNDI GREKE E LUFTËS / POET DHE MUZIKANT GREK					LUMË NË NIGERI / SULMI		
FITORE NË SHAH				KUSAR DETI / LIGJI, KANUNI (vjet.)				GRAM / ISH BASKETBOLL. I NBA-së, BIRD	
LUMI MË I MADH NË SHQIPËRI					ROMAN I SHATOBRAJANIT / TENISTJA, KURNIKOVA				
INGE ILIN			ENË QË NXË NJË OKË (shum.) / RËNTGEN, TEMP						
SOPRANOJA AMERIKANE, XHESI						NGJYRË NË LETRAT E BIXHOZIT / BELGJIKA			
"KUNDËR"				LOKALITET NË EGJIPT, NË AFËRSI TË ALEKSANDRISË					

E thotë shkencëtari rus: Alienët mund të na shkelin pa na parë fare

Sa më shumë njeriu vihet në kërkim të një forme tjetër inteligjente nëpër univers, aq më e fortë bëhet pyetja, a jemi të vetëm në këtë gjithësi? Të vetmet përgjigje që jepen për këtë pyetje që stërmundon njerëzimin prej dekadash e shekujsh mbërrijnë nga teoritë konspirative, ndërsa nga shkencëtarët ka një mori hipotezash. E këtyre hipotezave u shtohet një e re, që mbërrin nga një shkencëtar rus. Alexander Berezin, një emër i njohur i fizikës botërore shtjellon idenë e tij. Ai sugjeron se qytetërimi i parë që do të zhvillojë teknologjinë për të udhëtuar mes yjeve pashmangshmërisht do të shfaroste qytetërimet e tjera. "Është njësoj si një ndërtues, që për të ngritur një pallat nuk pyet se do të shembë një hoje milingonash", deklaron shkencëtari rus i Universitetit të Teknologjisë Elektronike. Kjo, sipas tij, jo domosdoshmërisht do të thotë që jashtëtokësorët janë agresivë, apo të këqij, por thjesht nuk do ta vinin re ekzistencën tonë, nëse në një skenar të mundshëm do të mbërrinin në Tokë. Për ta ilustruar akoma më mirë idenë e tij, sjell si shembull historinë njerëzore, fillimisht me kolonializimin dhe më pas me kapitalizmin, dy epoka të ndryshme që kanë shkatërruar kultura dhe qytetërime autentike me përhapjen e tyre.

Një vezë në ditë mban larg sëmundjet e zemrës

Ka qenë një reklamë e famshme në vitet 1950, edhe pse më vonë u ndalua pasi nuk promovonte dietë të balancuar. Por studiuesit thonë se duhet një vezë në ditë për të reduktuar infarktin apo sëmundjet e zemrës. Krahasimi është bërë me ata që e konsumojnë rrallë vezën. Sipas rezultateve të shkencëtarëve të Qendrës Universitare të Shkencës së Shëndetit në Pekin dhe Oksfordit, ka mjaft lidhje mes konsumit të një veze, infarktit dhe sëmundjeve kardiovaskulare. Në fakt studimi ka qenë vetëm vëzhgues, dhe sipas autorëve ndihmon në krijimin e një diete të shëndetshme. Veza përmban proteina, vitamina, minerale dhe acide yndyrore thelbësore dhe ka pak acide të ngopura.

Më shumë se dy fëmijë dëmton shëndetin e nënës!

Shumë prindër e pranojnë se fëmijët rrisin nivelin e stresit, por një studim i fundit thotë se më shumë se dy fëmijë dëmtojnë vërtetë shëndetin e nënës.

Sa më shumë fëmijë të ketë një femër, më i lartë është rreziku i sëmundjeve të zemrës. Ndërsa ato që kanë më shumë se pesë fëmijë, kanë një rrezik 40% më të lartë për një infarkt serioz në zemër në 30 vitet e ardhshme, krahasuar me ato që kanë një apo dy fëmijë.

Shtatzënia dhe procesi i lindjes e tendosin zemrën, teksa fëmijët bëhen stresues dhe i ndalojnë nënat të kujdesen për veten e tyre, vijon studimi i Kembrixhit.

"Ne e dimë që shtatzënia dhe procesi i lindjes tendosin zemrën në mënyrë të tmerrshme, dhe rritja e fëmijëve është stresuese gjithashtu. Ne nuk duam t'u shtojmë stresin njerëzve në jetën e përditshme por t'i vëmë në dijeni dhe çfarë të bëjnë për këtë", thotë drejtuesja e studimit Clare Oliver-Williams. Janë studiuar të dhënat e mbi 8 mijë femrave në SHBA të moshave 45 deri në 64 vjeç.

Çka duhet të pini së pari në mëngjes

Gjatë natës, gjersa jeni në gjumë trupi dehidratohet. Nuk keni pirë asgjë për disa orë dhe trupi ka nevojë që të marrë sasinë e duhur të ujit. E preferueshme është që gjëja e parë që bëni në mëngjes të jetë konsumimi i ujit, pa pirë apo ngrënë asgjë para këtij veprimi. Uji duhet të jetë i pastër, mos i shtoni limon apo diçka freskuese të ngjashme, sepse uji i pastër do të kalojë në organizëm menjëherë, kurse nëse përmban diçka do të mbetet më gjatë në bark dhe kështu nuk e kryen rolin për të cilin keni nevojë në mëngjes.

KALENDARI HISTORIK 9 QERSHOR

68 - Perandori romak Neroni bën vetëvrasje me ndihmën e sekretarit të tij Epafroditit.

922 - Republika e Francës zgjedh Robertin I, Mbret të Francës

1529 - Cyrihu i shpallë luftë kantoneve Katolike

1720 - Suedia dhe Danimarka nënshkruajnë Marrëveshjen e tretë të Stokholmit

1752 - Ushtria franceze iu dorëzohet asaj angleze në Trikinopoli, Indi

1815 - Përfundon Kongresi i Vjenës: Caktohet situatë e re politike në Evropë.

1923 - Premieri bullgar Stamboliski dhe Mbreti Borisi III përmbysen nga froni

1940 - Takimi i parë mes Gjeneral de Gol dhe Uinston Çerçillit

1942 - Nazistët vrasin të gjithë banorët e Lidices në Çekosllovaki

1963 - Xhon Kenedi shpall Uinston Çerçilliin qytetar nderi të SHBA

1968 - Kryetari i Jugosllavisë Tito premton reforma

1993 - Princi i Japonisë Naruhito martohet me Masaka Ouada

1999 - Lufta e Kosovës: Republika Federale e Jugosllavisë dhe NATO nënshkruajnë marrëveshje për paqe.

A E DINI SE...



Është vërtetuar që asnjë person nuk mund të teshtijë pa i mbyllur sytë. Shkencëtarët kanë bërë edhe eksperimente për këtë dhe kanë arritur në përfundimin se është e pamundur.



Një zemër normal i ka të rrahurat 72 herë në minutë! Kjo do të thotë që 100.000 herë në ditë, ose 3.600.000 në vit! Zemra e gjinisë femërore është 25% më e vogël se ajo e gjinisë mashkullore.

Një mace e quajtur Soks ishte kafsha më e famshme presidenciale si pjesë e familjes së Klintonit dhe qëndronte në Shtëpinë e Bardhë.

BARSOLETA

BORXHI I SHQIPTARIT

I kërkon shqiptari italianit 200 euro hua.

- Nuk kam për besë, vetëm 100 i kam, i përgjigjet italiani.
- Mi jep pra 100 dhe 100 të tjera mi ke borxh!

THËNIA E DITËS

Askush nuk mund të kthehet pas e të ketë një fillim të ri, por kushdo mund të nisë sot dhe të bëjë një fund të ri. **(Maria Robinson)**